



# Këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë

Gjetjet kryesore nga anketa  
ndërkombëtare mbi burrat dhe barazinë gjinore  
(IMAGES)



# **Këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë**

Gjetjet kryesore nga anketa  
ndërkombëtare mbi burrat dhe barazinë gjinore  
(IMAGES)

Ky raport është rezultat i bashkëpunimit mes Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyrës në Kosovë të Fondit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA) dhe UBO Consulting. Hulumtimi dhe përpilimi i raportit është financuar nga Përfaqësia e përhershme e Holandës pranë OSBE-së, Akademia Folke Bernadotte dhe buxheti themelor i UNFPA-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OSBE-së, UNFPA-së, Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo të ndonjë prej organizatave në kuadër të saj.

**© OSCE/UNFPA 2018 Të gjitha të drejtat e rezervuara.**

Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe kopjohet lirshëm për qëllime edukative dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që riprodhimi të shoqërohet me njohjen e UNFPA-së dhe OSBE-së si burim.

*Botuar nga:*

**Misioni i OSBE-së në Kosovë**

Abdyl Frashëri 37  
10000 Prishtinë  
Tel. +383 38 240 100  
press.omik@osce.org  
www.osce.org/kosovo

**UNFPA Kosovo**

Zagrebi 39  
10000 Prishtinë  
Tel. +383 38 249088  
kosovo.unfpa.org

*Propozimi për referencë/të citohet si:*

Misioni i OSBE-së në Kosovë/UNFPA Kosovë (2018):

*Këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë.*

*Gjetjet kryesore nga Anketa ndërkombëtare mbi burrat dhe barazinë gjinore (IMAGES).*

Prishtinë

*Mirënjohje*

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNFPA u shprehin mirënjohje të gjithë individëve dhe organizatave në vijim për kontributet dhe/ose përkrahjen e tyre: Instituti Promundo, Ruti Levto, Care International Balkans, Besnik Leka, John Crownover, Qendra Edukative e të Rinjve "Sinergjia", Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë, gjithë ekspertët të cilët morën pjesë në hulumtim, pjesëmarrësit në grupe të fokusit dhe i gjithë ekipi i UBO Consulting.

Çdo referencë që i bëhet Kosovës në këtë raport duhet të kuptohet në kontekst të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

## Përmbajtja

<b>1. Hyrje</b> .....	6
1.1. Përse duhet të analizohen qëndrimet dhe zakonet e burrave? .....	6
1.2. Historik i situatës në lidhje me barazinë gjinore në Kosovë .....	8
<b>2. Metodologjia</b> .....	10
2.1. Korniza konceptuale .....	10
2.2. Strategjia analitike .....	12
2.3. Kufizimet .....	12
<b>3. Rezultatet kryesore</b> .....	13
3.1. Kush ishin gratë dhe burrat pjesëmarrës? .....	13
3.2. Normat dhe qëndrimet gjinore ndaj barazisë gjinore .....	14
3.3. Përvojat e fëmijërisë .....	23
3.4. Dinamika e marrëdhënieve dhe punët e shtëpisë .....	29
3.5. Shkalla e dhunës dhe akteve kriminale .....	35
3.6. Shprehitë shëndetësore .....	39
3.7. Politikat dhe ligjet mbi barazinë gjinore .....	42
<b>4. Konkluzë</b> .....	47
<b>5. Rekomandime</b> .....	48
Referenca .....	50
Shtojca I - Lista e të intervistuarve për intervistat e hollësishme .....	52

## Përmbledhje ekzekutive

Ky studim është bazuar kryesisht në rezultatet e Anketës ndërkombëtare mbi burrat dhe barazinë gjinore (IMAGES). Është përdorur metodologji e kombinuar që ka përfshirë hulumtim nga zyra, anketë sasiore me 1001 burra dhe 500 gra, katër diskutime në grupe të fokusit dhe 26 intervista të hollësishme me palë kryesore të interesit dhe ekspertë. Hulumtimi është realizuar duke filluar nga muaji shkurt deri në qershor të vitit 2017. Qëllim kryesor ka qenë përfshirja e një pasqyre gjithëpërfshirëse të qëndrimeve dhe praktikave të burrave, bashkë me mendimet dhe raportet e grave sa u përket praktikave të burrave, mbi një varg temash të lidhura me barazinë gjinore në Kosovë.

### *Normat gjinore dhe qëndrimet ndaj barazisë gjinore*

Në këtë raport është përdorur një njësi matjeje e pranuar ndërkombëtarisht, Shkalla matëse e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore, për të matur qëndrimet ndaj normave gjinore në Kosovë. Shumica e burrave (dhe e grave) qëndrojnë brenda normave të barazisë së moderuar. Megjithatë, rreth 13 për qind e burrave i përkasin kategorisë së barazisë së ulët në normat gjinore krahasuar me vetëm një për qind të grave të cilat i përkasin kësaj kategorie. Shumica e burrave janë pajtuar me deklaratat që shprehin averzion ndaj diversitetit seksual, derisa gratë kanë shfaqur reagim paksa më të butë. Kur u është kërkuar mendimi rreth grave të moshës madhore dhe të mitur të cilat punojnë si punëtore seksi, burrat kishin më pak të ngjarë që ta konsideronin një gjë të tillë si moralisht të gabuar, madje edhe kur fjala ishte vetëm për vajza të moshës së mitur. Shkallët e vetë-deklaruara të marrëdhënieve seksuale transaksionale në mesin e burrave kanë qenë paksa më të larta seç kanë raportuar gratë.

### *Përvojat e fëmijërisë*

Sipas përvojave të fëmijërisë të shumicës së burrave, kujdesi për fëmijët dhe punët e shtëpisë kanë qenë obligim i nënave të tyre. Figurat mashkullore janë parë rrallëherë duke përgatitur ushqim apo duke bërë punët e shtëpisë, pasi që këto punë kanë qenë zakonisht të etiketuara si punë të grave. Burrat e grup-moshave më të reja ka më shumë gjasë t'i kenë parë baballarët e tyre apo figura të tjera mashkullore duke u angazhuar aktivisht në punë shtëpiake. Angazhimi më i madh në shtëpi i baballarëve apo figurave të tjera mashkullore ishte më i shpeshtë në rastet kur prindërit e respondentëve kanë pasur përgatitje shkollore të lartë. Rrallëherë ka ndodhur që nëna ta ketë pasur fjalën e fundit apo edhe të barabartë në lidhje me vendimet për shpenzimin e parave në investime të mëdha në shtëpi. Në të kaluarën, por edhe tash, ndonëse më rrallë, shuplakat dhe rrahjet janë konsideruar shpesh si pjesë normale e disiplinimit të fëmijëve. Rreth 40 për qind të burrave kanë pranuar se në shkollë apo në lagjen ku janë rritur ka ndodhur bullizëm dhe ngacmim. Ata të cilët kanë përjetuar dhunë të tillë në shkollë dhe në shtëpi ishin më të prirur për averzion ndaj barazisë gjinore.

### *Dinamika e marrëdhënieve dhe punët e shtëpisë*

Në shumicën e rasteve, vendimmarrja në familje bëhet bashkërisht nga të dy partnerët, por pjesa e burrave të cilët kanë thënë se është bashkëshortja apo partnerja ajo e cila e ka fjalën e fundit është shumë më e ulët. Burrat të cilët i kanë parë prindërit e tyre teksa vendosnin bashkë për çështje të rëndësishme familjare kishin më shumë të ngjarë që ta bëjnë po të njëjtën gjë me partneren. As punët e shtëpisë nuk janë të ndara në mënyrë të barabartë, meqë grave u bie mbi supë gati krejt barra. Si numri i burrave ashtu dhe ai i grave që marrin pushim të paguar amësie ose atësie është relativisht i ulët. Zakonisht, detyrat rreth përkujdesjes së fëmijëve ose ndaheshin mes dy partnerëve ose merreshin përsipër nga nëna. Burrat të cilët gjatë fëmijërisë kanë mësuar si të kujdesen për vëllain a motrën kishte më shumë gjasë që të jenë të angazhuar në përkujdesjen e përditshme të fëmijëve të vet.

### *Praktikat e dhunës dhe akteve kriminale*

Rezultatet e anketës tregojnë se dy në çdo dhjetë burra e kanë parë nënën e tyre teksa rrihej nga babai apo partneri i saj të paktën njëherë gjatë fëmijërisë. Për më tepër, afro 12 për qind e burrave ia kanë dhënë ndonjë shuplakë, goditur me grusht apo gjuajtur me ndonjë gjësend partneren të paktën një herë. Krahasuar me gratë, burrat kanë më shumë të ngjarë që të jenë dakord me normat e kulturës së përdhunimit. Gjithashtu, një në çdo 20 burra ka pranuar të ketë pasur marrëdhënie seksuale me një grua pa pëlqimin e saj të paktën njëherë në jetë, ndërsa një në çdo 25 burra ka raportuar se të paktën një herë e ka detyruar të dashurën apo bashkëshorten për të bërë seks.

### *Praktikat shëndetësore*

Rreth 11 për qind e grave dhe 16 për qind e burrave nuk kanë qenë asnjëherë te mjeku për t'u ekzaminuar për ndonjë problem shëndetësor. Rezultatet e anketës kanë shpalosur statistika brengosëse lidhur me shëndetin mendor po ashtu. 31 për qind e burrave kishin përjetuar stres gjatë muajit të fundit. Ndërsa, 14 për qind të tjerë kanë përjetuar depresion dhe pesë për qind e kanë pranuar të kenë pasur mendime për vetëvrasje të paktën nganjëherë. Rreth 14 për qind të burrave konsumojnë pije alkoolike dy herë në muaj apo dhe më shpesh. Nga ky grup, 28 për qind syresh e teprojnë me të pirë (më shumë se pesë pije përnjëherësh) të paktën një herë një javë. Përhapja e përdorimit të drogës ishte shumë më e ulët sesa ajo e konsumimit të alkoolit. Kërkimi i ndihmës për probleme të shëndetit mendor është parë si gjë tabu në shoqëri për shkak të mendësisë tradicionale dhe paragjyqimeve.

### *Politikat dhe ligjet për barazinë gjinore*

Të gjitha palët e intervistuar janë dakorduar njëzëri se korniza ligjore për barazinë gjinore në Kosovë është e rrumbullakësuar dhe formuluar mirë. Megjithatë, sipas përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave joqeveritare, problemi kryesor qëndron te zbatimi i këtyre ligjeve dhe politikave. Shkalla e vetëdijesimit për rregullimin ligjor të pushimit të lehonisë ka qenë më e lartë se sa për pushimin e atësisë. Ky i fundit, bashkë me ligjet që rregullojnë ndalimin e diskriminimit dhe marrëdhëniet familjare, janë konsideruar të jenë përgjithësisht të drejta nga popullsia. Megjithatë, respondentët kanë qenë të mendimit se dispozitat ligjore mbi dhunën në familje nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për viktimat e abuzimit.

# 1.Hyrje

Gjëja e parë që do t'u shkojë ndër mend shumë njerëzve me ta marrë këtë raport mund të jetë: Ja dhe një studim tjetër mbi barazinë gjinore i bërë nga gratë, dhe vetëm për gratë. Shpesh, barazia gjinore është kategorizuar si çështje grash dhe, kështu, studimet, diskutimet, debatet rreth kësaj teme nuk kanë arritur t'i prekin edhe shqetësimet e burrave. Megjithatë, pyetja që duhet shtruar është si mund të tejkalohen mospajtimet kur njëra palë e sheh këtë çështje si diçka pa rëndësi, ndërsa për palën tjetër është diçka jetike në jetën publike dhe private. Burrat dhe gratë duhet t'i shohin nga afër dhe të përpiqen t'i kuptojnë pikëpamjet, përvojat dhe problemet e njëri-tjetrit. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse ka për qëllim t'i japë barazisë gjinore rëndësinë e merituar gjithëpërfshirëse, duke dalë jashtë botës së grave dhe duke u shtrirë në tërë shoqërinë. Nën-pjesët në vazhdim e sqarojnë në hollësi konceptin dhe arsyen e këtij studimi, si dhe japin informata lidhur me sfondin e gjendjes aktuale të barazisë gjinore në Kosovë<sup>1</sup>.

## 1.1. Përse duhet të analizohen qëndrimet dhe zakonet e burrave?

Po të nisemi nga bindja se barazia gjinore nuk kufizohet vetëm përbrenda domenit të shqetësimeve të grave, atëherë përfundimi i pashmangshëm që do të arrihet është se kjo çështje është një lloj e rëndësishme si nga këndvështrimi i një gruaje ashtu dhe ai i një burri. Duke ditur që për dekada të tëra diskursi dhe politikat për barazinë gjinore janë nxitur nga gratë dhe kanë pasur të bëjnë vetëm me gratë, koncepti në themel të këtij projekti është që fokusi të bie pikërisht mbi atë që është anashkaluar shpeshherë - **pikëpamja e burrave mbi barazinë gjinore**.

Kjo qasje po fiton gjithnjë e më shumë popullaritet në agjendat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare në dekadat e fundit. Për shembull, **Deklarata e Pekinit** e Kombeve të Bashkuara, që synon të sigurojë zbatimin e plotë të të drejtave njerëzore të grave në mënyrë të gjithmbarshme, përmban një pikë të posaçme për "Nxitjen e burrave që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha veprimet drejt barazisë."<sup>2</sup> Përpjekja për arritjen e barazisë gjinore në dobi si të burrave ashtu dhe grave është prioritet në Planin e veprimit të vitit 2004 për promovimin e barazisë gjinore të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).<sup>3</sup> Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA), i udhëhequr nga Programi i veprimit i vitit 1994 i Konferencës ndërkombëtare mbi popullsinë dhe zhvillimin<sup>4</sup>, ka ndërmarrë po ashtu një sërë hapash për t'i përfshirë burrat në përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore.

**“Që në fillimet e punës sime me organizatat për barazi gjinore jemi munduar që nëpër aktivitetet tona t'i përfshijmë burrat sa më shumë që të jetë e mundshme. Një gjë e tillë kishte rëndësi sidomos në rastin e shoqërisë kosovare, meqë burrat u kushtonin më tepër vëmendje burrave tjerë. Kur babai i largonte vajzat nga shkolla, kjo gjë kishte ndikim shumë më të madh tek të tjerët sesa kur nënat e bënë të njëjtën gjë.**

Igalle Rogova  
Drejtoreshë Ekzekutive  
Rrjeti i Grave të Kosovës

<sup>1</sup>Draft raporti është përgatitur nga Donika Limani, Kujtim Koci, Ebru Süleyman, Anila Qehaja dhe Valon Feka nga ekipi i UBO Consulting. Ky raport është redaktuar nga Saša Gavrić, Këshilltar për Çështje Gjinore pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, dhe Visare Mujko-Nimani, Eksperte e Programit pranë Zyrës së UNFPA-së në Kosovë, lektoruar nga Alex Sales, dizajnuar nga Yllka Fetahaj dhe ilustrimet nga Florentina Pllana. Raporti i pasqyron zhvillimet deri në fund të vitit 2017.

<sup>2</sup> Kombet e Bashkuara (1996). *Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim: Konferenca e katërt botërore për gratë, Pekin, Kinë, 4-15 shtator 1995*. Kombet e Bashkuara

<sup>3</sup> OSBE (2004). *Plani i veprimit i OSBE-së për promovimin e barazisë gjinore*. Vendimi nr. 14/04 i Këshillit Ministror. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Në dispozicion në: <https://www.osce.org/mc/23295?download=true>

<sup>4</sup> Kombet e Bashkuara (2014). *Programi i veprimit i miratuar në Konferencën ndërkombëtare mbi popullsinë dhe zhvillimin, Kajro, 5-13 shtator 1994. Edicioni i 20 vjetorit*. UNFPA.



Ndër përpjekjet e UNFPA-së që vlen të përmenden është udhëzuesi “Angazhimi i burrave dhe djemve për barazi gjinore dhe shëndetësi - Udhëzues global për veprim”, që paraqet informata konceptuale dhe praktike rreth angazhimit të burrave dhe djemve në promovimin e barazisë gjinore dhe shëndetit<sup>5</sup>. Komisioni i OKB-së mbi Statusin e Gruas, në Përfundimet e dakorduara nr. 4 të tij, “Roli i burrave dhe djemve në arritjen e barazisë gjinore”, ka theksuar përgjegjësinë që bartin si gratë ashtu dhe burrat për të promovuar dhe kontribuar për barazinë gjinore në sfera të ndryshme të shoqërisë<sup>6</sup>. Veç kësaj, Strategjia e Komisionit Evropian për barazinë gjinore midis grave dhe burrave 2010-2015 dhe dokumenti pasues Angazhimi strategjik për barazi gjinore 2016-2019 ka theksuar domosdoshmërinë e kontributit aktiv të burrave për ta çuar përpara barazinë gjinore<sup>7</sup>.

Pyetja që duhet të shtrohet është: a janë burrat të pajtimit me sistemimin ndërkombëtar të agjendave të barazisë gjinore? A po marrin përsipër pronësinë për porositë dhe politikat që bëjnë thirrje për barazi më të madhe për vajzat dhe gratë në shkollim, të ardhura e punësim, pjesëmarrje politike e shëndetësi? A po i ndryshojnë qëndrimet, zakonet dhe mënyrën e jetesës në raport me gratë? Çfarë përvoja po krijojnë burrat kur është fjala për shëndetësinë, punësimin apo jetën private? Shumë nga këto pyetje kanë qenë objekt hulumtimi i studimeve të shumta. Megjithatë, Anketa ndërkombëtare mbi burrat dhe barazinë gjinore (IMAGES) siguron një mekanizëm më gjithëpërfshirës për pasqyrimin e gjithë këtyre aspekteve në një studim të vetëm.

IMAGES në Kosovë është pjesë e nismës botërore për të ofruar një pasqyrim më të baraspeshuar dhe gjithëpërfshirës për çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. **Anketa IMAGES** është përpiluar dhe bashkërenduar nga Instituti Promundo dhe Qendra Ndërkombëtare për Kërkime mbi Gruan. Si një ndër studimet më gjithëpërfshirëse të ekonomive familjare të kryera ndonjëherë në lidhje me qëndrimet dhe zakonet e burrave dhe grave për sa i përket barazisë gjinore, kjo anketë është realizuar në më se 20 vende deri më sot, duke përfshirë këtu Bosnjën e Hercegovinën, Kroacinë dhe Moldavinë<sup>8</sup>. Në Kosovë, IMAGES është pjesë e nismës së përbashkët të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Zyrës së UNFPA-së në Kosovë. Qëllim kryesor është nxjerrja e një pasqyre gjithëpërfshirëse të perceptimeve dhe qëndrimeve aktuale për sa u takon roleve gjinore në Kosovë. Këto rezultate do të ndërtojnë bazën e të dhënave rreth mënyrës së adresimit të pabarazisë gjinore përmes fushatave të vetëdijesimit, si dhe për të avokuar për ndryshime në institucionet publike dhe, ç’ është më e rëndësishmja, për t’i përfshirë burrat në programe të barazisë gjinore.

<sup>5</sup> Ricardo, C., & Verani, F. (2010). *Angazhimi i burrave dhe djemve në barazi gjinore dhe shëndetësi: Udhëzues global për veprim*. Brazil: Promundo/UNFPA.

<sup>6</sup> Komisioni i OKB-së mbi Statusin e Gruas. (2004, Mars). *Roli i burrave dhe djemve në arritjen e barazisë gjinore - Përfundimet e dakorduara CSW48 (A)*. Kombet e Bashkuara.

<sup>7</sup> Komisioni Evropian. (21 shtator 2010). *Strategjia për barazinë midis grave dhe burrave 2010-2015*.

dhe Komisioni Evropian (2011). *Angazhimi strategjik për barazi gjinore 2016-2019*

<sup>8</sup> Mëso më shumë rreth realizimit të projektit globalisht në faqen e internetit të Institutit Promundo : <https://promundoglobal.org/programs/international-men-and-gender-equality-survey-images/>

## 1.2. Historik i situatës në lidhje me barazinë gjinore në Kosovë

Në vitin 2004, Kosova miratoi Ligjin e parë për barazi gjinore. Që atëherë, institucionet kanë ndërmarrë hapa të mëtejme për ta përmirësuar **kuadrin ligjor dhe institucional** për promovimin e barazisë gjinore. Në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi legjislacion të ri për barazinë gjinore dhe ndalimin e diskriminimit, si dhe Ligjin e ri për Institucionin e Avokatit të Popullit<sup>9</sup>. U ngritën mekanizma institucionalë për të udhëhequr, mbështetur dhe/ose monitoruar realizimin e barazisë më të madhe gjinore. Në kuadër të legjislativit ekziston një komision parlamentar që merret me barazinë gjinore, gjersa në ekzekutiv është Agjencia për Barazi Gjinore që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Të gjitha ministritë kanë zyrtarë për barazi gjinore. Në nivel lokal janë komitetet e kuvendit të komunës që merren me barazi gjinore dhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore. Institucioni i Avokatit të Popullit është përgjegjës për trajtimin e ankesave lidhur me diskriminimin në baza gjinore. Zhvillime domethënëse ka pasur dhe në **nivel të politikave**. Megjithatë, në Strategjinë zhvillimore të Kosovës që është aktualisht në fuqi vetëm dy nga 34 objektivat janë të lidhura me çështjet gjinore<sup>10</sup>. E para ka të bëjë me rritjen e shkallës së regjistrimit të fëmijëve në nivelin parashkollor si mekanizëm për lehtësimin e punësimit të grave, ndërsa e dyta ka të bëjë me rritjen e qasjes së grave në të drejtat pronësore. Edi Gusia, drejtoreshë e Agjencisë për Barazi Gjinore, ka vënë në dukje se këto objektiva nuk mjaftojnë për t'i adresuar problemet me barazinë gjinore në Kosovë dhe se ka padyshim më shumë vend për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe në fusha tjera.

Vlerësimi që i është bërë strategjisë qeveritare për barazi gjinore, Programit të Kosovës për barazi gjinore 2008-2013<sup>11</sup>, ka shpalosur se përkundër përparimit të arritur me ca nga treguesit socio-ekonomik, gjer në vitin 2013, gratë në Kosovë ishin në pozitë disavantazhi krahasuar me burrat<sup>12</sup>. Derisa shkalla e gjithmbarshme e papunësisë në mesin e popullsisë është jashtëzakonisht e lartë me rreth 33 për qind, dallimi mes përqindjeve totale për gratë dhe burrat nuk është i madh (32 për qind për burrat dhe 37 për qind për gratë)<sup>13</sup>. Megjithatë, hendeku i shkallës së papunësisë zgjerohet edhe më kur merret në konsideratë përgatitja shkollore. Papunësia është më e shprehur në mesin e grave me përgatitje më të lartë shkollore sesa për burrat e të njëjtit grup; 28 për qind e grave me përgatitje të lartë shkollore janë të papuna krahasuar me 15 për qind të burrave të së njëjës kategori<sup>14</sup>. Hendeku në shkallën e pjesëmarrjes në tregun e punës është edhe më i shprehur. Në vitin 2013, shkalla e pjesëmarrjes së grave ka qenë 21 për qind, shifër kjo që konsiderohet e ulët.<sup>15</sup> Gratë janë të prirura të mbajnë pozita që paguhen më pak dhe pothuajse nuk mbajnë asnjë pozitë të lartë menaxheriale në sektorin privat (vetëm 7 për qind)<sup>16</sup>, derisa në vitin 2014 përqindja e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse të larta dhe të mesme ka qenë rreth 16 për qind<sup>17</sup>. Nga 70.326 nëpunës publikë të Kosovës, vetëm 38 për qind janë gra. Gratë mbajnë vetëm 9 për qind të pozitave të larta vendimmarrëse sikurse ato të sekretarit të përgjithshëm apo shefit ekzekutiv dhe 23 për qind të pozitave tjera vendimmarrëse në nivel të mesëm<sup>18</sup>.

<sup>9</sup>Që të tria ligjet janë në dispozicion në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe në faqen e internetit të Gazetës Zyrtare tek gzk.rks-gov.net

<sup>10</sup>Zyra e Kryeministrit të Kosovës (Janar 2016). *Strategjia zhvillimore 2016-2021*.

<sup>11</sup>Programi i ri për barazi gjinore nuk është miratuar akoma. Finalizimi dhe miratimi i tij nevojitet të bëhet urgjentisht për të drejtuar në mënyrë sistematike me punën e institucioneve të ndryshme qeveritare.

<sup>12</sup>Agjencia për Barazi Gjinore (2016). *Vlerësim i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore*.

<sup>13</sup>Organizata Ndërkombëtare e Punës (2017) *Baza e të dhënave ILOSTAT*.

<sup>14</sup>Organizata Ndërkombëtare e Punës (2017) *Baza e të dhënave ILOSTAT*.

<sup>15</sup>Banka Botërore (2017) *Baza e të dhënave me statistika gjinore*.

<sup>16</sup>Banka Botërore (2017) *Anketat e Bankës Botërore me ndërmarrjet*.

<sup>17</sup>Organizata Ndërkombëtare e Punës (2017) *Baza e të dhënave ILOSTAT*.

<sup>18</sup>Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (2014). *Rreziqet dhe cenueshmëritë e korrupsionit që kanë të bëjnë me barazinë gjinore në shërbimin civil të Kosovës*.

Përkundër të drejtave trashëgimore të barabarta me ligj dhe masave afirmative për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve, në vitin 2017 numri i grave të cilat kanë pronë të regjistruar në emër të vetin përbënte rreth 20 për qind të popullsisë<sup>19</sup>. Gjithashtu, sipas rezultateve nga Regjistrimi i bujqësisë në Kosovë në vitin 2014, vetëm pesë për qind e tokës bujqësore është në pronësi të grave. Madje dhe në sektorin tregtar gratë vijnë shumë pak në shprehje me vetëm 13 për qind të bizneseve në pronësi të tyre<sup>20</sup>. Kjo gjendje rrënjët i ka te normat tradicionale shoqërore që janë përqafuar si nga burrat ashtu dhe gratë, ku gruaja nënshtrohet si qytetar i dorës së dytë dhe ndarja e burimeve familjare ndjek vijën e gjakut të babait.

Hendeku gjinor është i shprehur po ashtu edhe në **sektorët e arsimit dhe shëndetësisë**, e që janë të ndërlidhur ngushtë me temat e trajtuara në këtë hulumtim. Për shembull, të dhënat për vitin 2011 tregojnë se vetëm 11 për qind e grave, krahasuar me 30 për qind të burrave, kanë mbaruar shkollimin e mesëm (të lartë)<sup>21</sup>. Shumica e grave kanë mbaruar vetëm shkollën fillore ose të mesme të ulët, porse nuk kanë aftësim formal profesional. Duhet të ceket se gjatë vitit akademik 2015/2016 numri i grave të regjistruara nëpër universitete publike ka qenë më i lartë në të gjitha komunat pa dallim, dhe në pothuaj gjitha universitetet publike numri i grave të diplomuara ka qenë më i madh sesa i burrave<sup>22</sup>. Ndryshe nga fushat tjera, gratë qëndrojnë më mirë se burrat në kuptimin e treguesve shëndetësorë. Në vitin 2015, jetëgjatësia e grave ka qenë 73.6 vjet, gjersa për burrat ka qenë 69.2<sup>23</sup> vjet. Një studim i realizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës ka gjetur se ka më shumë të ngjarë që gratë të kërkojnë shërbime shëndetësore se burrat<sup>24</sup>.

Përkundër ekzistimit të kuadrit ligjor dhe politikave për barazi gjinore, dhuna në baza gjinore vazhdon të jetë e pranishme. Me përjashtim të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, dhuna në familje dhe format tjera të dhunës në baza gjinore vazhdojnë të jenë të përhapura në periudhën pas konfliktit. Një studim i realizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës ka identifikuar problematika të ndryshme me legjislacionin kundër dhunës në familje si rezultat i intervistimit të gjyqtarëve të lëmisë civile<sup>25</sup>. Këtu përfshiheshin shpërfillja e provave, burgosja e rrallë e kryerësve, vonesat në shqiptimin e urdhrave mbrojtës, mosvazhdimi adekuat i urdhrave mbrojtës dhe shqiptimi i dënimeve të buta në rastet e shkeljes së urdhrave mbrojtës. Megjithatë, studimet kanë gjetur dështime të shumta në reagimet e institucioneve në raste të tilla, disa prej të cilave janë: mungesa e kapaciteteve për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje siç duhet, mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore, situata jostabile e strehimoreve ekzistuese, dështimet për t'i bashkërenduar reagimet e agjencive të ndryshme siç duhet, si dhe një mosndjeshmëri e përgjithshme nga ana e institucioneve dhe shoqërisë në tërësi ndaj dhunës me bazë gjinore<sup>26</sup>. Nevojitet përkushtim i fuqishëm nga ana e institucioneve qeveritare për zbatimin e Strategjisë për mbrojtje nga dhuna në familje 2016-2020.

<sup>19</sup> Joireman, S. (2017). *Anketa kombëtare afatmesme për të drejtat pronësore në Kosovë*. USAID & Tetra Tech.

<sup>20</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2016). *Gratë dhe burrat në Kosovë, 2014-2015*.

<sup>21</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2016). *Gratë dhe burrat në Kosovë, 2014-2015*.

<sup>22</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/Agjencia e Statistikave të Kosovës (2016). *Statistikat mbi arsimin në Kosovë 2015/2016*.

<sup>23</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës (2017) *Baza e të dhënave ILOSTAT*.

<sup>24</sup> Farnsworth, N., & Goebels, K. (2016). *Qasja në shëndetësi në Kosovë*. Rrjeti i Grave të Kosovës.

<sup>25</sup> Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Berisha, A., & Morina, D. (2015). *Mjaft më me arsytimit: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*. Rrjeti i Grave të Kosovës.

<sup>26</sup> Kelmendi, K. (2015). Dhuna në familje e ushtruar ndaj grave në Kosovë: Studim cilësor i përvojave të grave. *Journal of Interpersonal Violence*, 30(4), 680-702. Shih po ashtu Raportin e reagimit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë <http://www.osce.org/kosovo/203051?download=true>

## 2. Metodologjia

### 2.1. Korniza konceptuale

Korniza konceptuale e zbatuar në këtë studim e ndjekë atë të hulumtimit origjinal IMAGES, siç është dizajnuar nga Instituti Promundo dhe Qendra Ndërkombëtare për Kërkime mbi Gruan. Instrumentet kërkimore të përdorura fillimisht janë përshtatur në kontekstin lokal të Kosovës. Pikëpamjet e grave dhe burrave analizohen në mënyrë neutrale, me ç'rast asnjëri palë nuk i jepet më tepër rëndësi se tjetrës. Bazuar në këtë kornizë konceptuale, studimi ngërthen një sërë temash, që në asnjë rast nuk duhen konsideruar si shterim i gjithë faktorëve që lidhen me normat gjinore dhe barazinë gjinore. Në anketë janë përfshirë fushat e mëposhtme:

- **Përvojat e fëmijërisë:** përjetimi i dhunës; të qenurit dëshmitar i dhunës në baza gjinore; qëndrimet e lidhura me gjininë ashtu si perceptohen në familjen e origjinës; ndryshimet e perceptuara nga gjenerata e mëparshme tek e tanishmja; balanci gjinor në punë/kujdesi ndaj fëmijëve në familjen e origjinës.
- **Raportet në shtëpi:** statusi martesor/bashkëjetesës; ndarja/pjesëmarrja në punë shtëpiake; kënaqshmëria e perceptuar me jetën familjare; shfrytëzimi i kohës në punë shtëpiake specifike dhe përkujdesje ndaj familjes, përfshirë këtu përkujdesjen ndaj fëmijëve.
- **Kujdesi prindëror dhe raportet e baballarëve me fëmijët e tyre:** numri i fëmijëve; situata e jetesës nën një kulm me secilin fëmijë; koha/paratë e shpenzuara për përkujdesjen ndaj secilit fëmijë; shfrytëzimi i pushimit të lehonisë/atësisë; perceptimet/qëndrimet ndaj pushimit të lindjes dhe aranzhimet lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijëve.
- **Qëndrimet ndaj grave dhe maskulinitetit:** qëndrimet ndaj barazisë gjinore (duke përdorur Shkallën e matjes së qëndrimeve të burrave ndaj barazisë gjinore dhe njësitë tjera matëse); qëndrimet ndaj politikave publike të ndryshme për barazi gjinore.
- **Shëndeti dhe cilësia e jetës:** pyetje rreth mënyrës së jetesës sjelljet seksuale dhe riprodhuese; infeksionet që transmetohen seksualisht; kënaqshmëria me marrëdhëniet seksuale; problemet me shëndetin mendor; përkrahja sociale.
- **Raportet mes partnerëve dhe raportet bashkëshortore:** statusi i tanishëm dhe kënaqshmëria me marrëdhënien; përdorimi i shërbimeve/kërkimi i ndihmës në situata të dhunës apo stresit në marrëdhënie; marrëdhëniet e kaluara.
- **Dhuna në marrëdhënie dhe seksi transaksional:** përdorimi i dhunës (fizike, seksuale, psikologjike) ndaj partnerit; viktimizimi i dhunës nga ana e partnerit; përdorimi i dhunës seksuale nga ana e burrave ndaj jopartnerëve; blerja e shërbimeve seksuale apo pagesa për seks e vetë-deklaruar nga burrat, përfshirë këtu me persona të moshës së mitur<sup>27</sup>.

Disa prej temave të përfshira në **dy pyetësorët (njëri për burra, tjetri për gra)** kanë qenë shumë të ndjeshme. Prandaj, vëmendje e veçantë i është kushtuar përzgjedhjes së pyetjeve që do të përfshihen në pyetësor dhe formulimit të tyre, duke u përpjekur njëherazi që të mos devijohet nga pyetësorët origjinalë të përdorur nga Instituti Promundo dhe Qendra Ndërkombëtare për Kërkime mbi Gruan. Kjo e fundit ka qenë sidomos me rëndësi për arritjen e rezultateve ndërkombëtarisht të krahasueshme. Pas përshtatjes së tyre, pyetësorët janë përkthyer me metodën e ri-përkthimit. Më pas, pyetësorët janë programuar në tablet të cilët u janë shpërndarë anketuesve për intervistat e ekonomive familjare. Veç kësaj, është realizuar edhe një pilot testim për ta testuar cilësinë, relevancën dhe qartësinë e pyetësorit. Informatat kthyesë dhe komentet janë inkorporuar në versionet përfundimtare të pyetësorit.

<sup>27</sup>Është me rëndësi të ceket se disa nga pyetjet e hulumtimit lidhen me çështje që mund të konsiderohen të kundërligjshme sipas kornizës ligjore aktuale. Roli i hulumtimeve në fushën e shkencave sociale është që të shqyrtohen edhe dukuritë e këtylla dhe rezultatet të paraqiten në mënyrë anonime. UBO Consulting, OSBE dhe/ose UNFPA nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për të dhënat e tilla.

**Mostra** është ndërtuar duke shfrytëzuar të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 për të 38 komunat. Së pari, janë krijuar dy mostra të veçanta, njëra për burrat dhe tjetra për gratë. Në përputhje me metodologjitë e mëparshme të IMAGES, madhësia e mostrës për burrat është më e madhe, meqë janë edhe target grup i studimit. Dy mostrat u bazuan në popullsinë e 38 komunave të Kosovës, duke lejuar njëkohësisht edhe mostra për përfaqësim të tre grupeve etnike: shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera pakicë.

Mostra u projektua bazuar në metodën e probabilitetit në proporcion me madhësinë (PPM) që gjithashtu na lejoi të ndajmë kuota për variablat siç janë: komunat dhe vendbanimet urbane dhe rurale. Mostra e përfaqësuesve të komunitetit, të cilët nuk ishin shqiptarë të Kosovës, u shumëfishuan për të qenë në gjendje të ofrojnë qëndrime përfaqësuese të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, të cilat do të mundësojnë analizë të nivelit të nën-mostrës. Në nivel të përgjithshëm të mostrës (përgjithësimi i gjetjeve të popullsisë), korrigjimet ex-post të mostrës, siç është aplikimi i peshës, u aplikuan për të korrigjuar teprinë e mostrave. Tabela në vijim paraqet mostrën e përgjithshme për anketimin me burrat dhe gratë.

	Totali	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Kosovarë të tjerë
Burra	1001	667	198	136
Gra	500	333	102	65
<b>Totali</b>	<b>1501</b>	<b>1000</b>	<b>300</b>	<b>201</b>

Tabela 1 - IMAGES mostra sipas etnisë dhe gjinisë

Krahas anketimit sasior, hulumtimi përfshiu edhe **metoda cilësore**, të cilat kryesisht janë marrë me dhënien e shpjegimit të thuktë të rezultateve të anketës, si dhe çështjeve të tjera të rëndësishme të ndërlidhura gjinore që ndodhin në Kosovë. Pas analizës së parë të të dhënave të anketës, u zhvilluan diskutime në katër **grupe fokusi** me banorë të Kosovës. Duke pasur parasysh barrierat gjuhësore, diskutimet në dy fokus grupe u zhvilluan me folës serbë të Kosovës dhe dy të tjera me folës shqiptarë të Kosovës. Këto diskutime u mbajtën veçmas me burrat dhe gratë, duke pasur parasysh kontekstin lokal, si dhe ndjeshmërinë e temës. Qëllimi kryesor i fokus grupeve ishte të hulumtonin shpjegime, konkluzione dhe të kuptonin më mirë qëndrimin e burrave ndaj barazisë gjinore, si nga perspektiva e tyre ashtu dhe nga ajo e grave.

Janë kryer njëzet e gjashtë **intervista të hollësishme** me hisedarë që punojnë në çështjet e barazisë gjinore (përfaqësues nga institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe akademia). Lista e plotë e të intervistuarve mund të gjendet në Shtojcën I. Informacioni nga intervistat e hollësishme ka mundësuar që të marrim një perspektivë shumëpalëshe mbi zhvillimet aktuale, ndërgjegjësimin dhe pengesat kryesore në lidhje me barazinë gjinore në Kosovë. Të gjitha aktivitetet kërkimore janë kryer gjatë periudhës shkurt-qershor 2017.

## 2.2. Strategjia analitike

Strategjia analitike e aplikuar në studimin e të dhënave të marra në këtë hulumtim është në përputhje me studimet e tjera të kryera të IMAGES. Gjetjet e prezantuara në kapitullin e radhës nuk i adresojnë të gjitha pyetjet që mbulohen nga hulumtimi sasior dhe cilësor. Studimi i paraqet vetëm rezultatet më të rëndësishme të bazuara në studimet e mëparshme në këtë fushë tematike dhe, çka është më e rëndësishme, në kontekstin lokal në Kosovë. Rezultatet e anketës janë plotësuar me përfundimet nga intervistat e hollësishme, si dhe me reagimet nga diskutimet e fokus grupeve. Të dhënat janë paraqitur veçmas për burrat dhe gratë për shkak të pyetësorëve të ndryshëm dhe madhësive të mostrës. Disa nga rezultatet kryesore për burrat janë analizuar më tej me qëllim të kapjes së prirjeve bazuar në sfondin socio-ekonomik të respondentëve dhe qëndrimet ndaj barazisë gjinore. Në rast se nuk thuhet ndryshe, në studim janë raportuar vetëm rezultatet e rëndësishme në interval të besueshmërisë prej 99 për qind.

## 2.3. Kufizimet

Ky lloj hulumtimi është ndër të parët e këtij lloji në Kosovë, duke pasur parasysh shkallën e gjerë të mbulimit dhe, në veçanti, llojin e ndjeshëm të temave që trajton. Prandaj, ballafaqimi me ca vështirësi ishte i natyrshëm gjatë realizimit të tij. Për shembull, shkalla e probabilitetit të lartë të refuzimit dhe braktisjes së pyetësorëve ishte parashikuar duke u bazuar në gjatësinë dhe, më me rëndësi, ndjeshmërinë e pyetësorëve. Masa të ndryshme u ndërmorën për t'i tejkaluar këto kufizime. Së pari, u angazhua numër adekuat i anketuesve burra dhe gra dhe u miratua një politikë e intervistimit nga anketues të së njëjtës gjini. Me fjalë të tjera, vetëm gratë mund t'i intervistonin gratë, dhe e njëjta vlente edhe për burrat. Masë e dytë ishte që pyetjet jashtëzakonisht personale dhe të ndjeshme të shtyheshin për pjesën përfundimtare të pyetësorit, që administroheshte nga vetë respondentët. Kjo lehtësoi procesin, meqë të intervistuarit nuk tronditeshin që në fillim nga pyetje të hapura duke ju dhënë atyre privatësi për të dhënë përgjigje më të sinqerta. Megjithatë, ka mjaft raste kur nuk janë dhënë përgjigje në pyetjet më të ndjeshme dhe personale. Një kufizim tjetër ishte gjatësia e pyetësorëve. Kjo shpesh rezultoi me lodhje të intervistuesve dhe respondentëve. Për kapërcimin e kësaj pengese, pyetësi u përshtat duke i hequr pyetjet e tepërta, dhe njëkohësisht duke e zgjatur në mënyrë të konsiderueshme kohën e përkushtuar për punën në terren për të mos nxituar procesin.

## 3.Rezultatet kryesore

### 3.1. Kush ishin gratë dhe burrat pjesëmarrës?

#### Sfondi social

Siç u shpjegua më parë tek metodologjia, përkatësia etnike e respondentëve u paracaktua nga kuotat për të ruajtur një mostër përfaqësuese etnike. Tabela 2 tregon se kategorizimi sipas moshës së respondentëve burra dhe gra anon kah grup-moshat më të reja, duke e reflektuar strukturën e popullsisë në Kosovë. Shumica e respondentëve burra dhe gra kanë përfunduar së paku shkollën e mesme ose ndonjë lloj shkollimi profesional. Shumë pak njerëz kanë deklaruar se nuk i përkasin asnjë feje (gjashtë për qind e burrave dhe katër për qind e grave). Tabela 2 ofron të dhëna për përkatësinë fetare vetëm të atyre që pohuan të ishin pjesë e një feje. Respondentët burra dhe gra raportuan kryesisht se janë të martuar. Shumë pak prej respondentëve jetojnë vetëm, dhe rreth 70 për qind të tyre kishin familje nga katër e deri në shtatë anëtarë. Në mesin e anëtarëve të familjes të deklaruar zakonisht janë partneri, fëmijët ose prindërit për burrat, dhe vjehërria për gratë.

Karakteristikat Demografike						
Grup-mosha	18-24	25-34	35-44	45-54	55-60	
Burra	28.6%	26.5%	18.9%	13.9%	12.1%	
Gra	24.7%	25.0%	22.9%	19.2%	8.2%	
Shkalla më e lartë e shkollimit	Pa shkollim	Shkollim fillor	Shkollë e mesme/ Shkollë profesionale	Niveli i parë universitar (Bachelor/Diplomë)	Niveli i dytë universitar (Master/Doktoratë) apo më lartë	
Burra	0.5%	11.9%	64.1%	20.7%	2.8%	
Gra	3.8%	30.4%	43.4%	19.5%	2.9%	
Fetarë	Po			Jo		
Burra	94%			6%		
Gra	96%			4%		
Feja	Musliman	Ortodoks	Katolik	Agnostik	Protestant	Pa përgjigje
Burra	93.7%	4.0%	1.8%	0.4%	0.0%	0.1%
Gra	94.5%	3.4%	0.9%	0.6%	0.1%	0.6%
Statusi martesor	Beqar/e	Në marrëdhënie	I/E fejuar	Bashkëjetesë, por pa u martuar	I/E martuar	I/E ve
Burra	32.4%	7.5%	4.1%	0.3%	53.5%	2.3%
Gra	28.5%	3.3%	3.1%	2.2%	58.4%	4.5%

Tabela 2 – Karakteristikat socio-demografike të respondentëve burra dhe gra

Në fund, shkalla e vetë-deklaruar e orientimit seksual tregon se 94 për qind e burrave tërhiqen nga gratë, 2 për qind tërhiqen si nga gratë edhe nga burrat, derisa vetëm 0.3 për qind (3 nga 1001) kanë thënë se i preferojnë burrat. Katër për qind nuk kanë dashur të përgjigjen në këtë pyetje. Të dhënat për gratë tregojnë se 84 për qind i preferojnë burrat, dy për qind tërhiqen nga të dy gjinitë dhe 14 për qind nuk kanë dashur të përgjigjen në këtë pyetje. Rezultatet e hulumtimit e shfaqura tutje bazohen në konceptin heteroseksual të një marrëdhënieje.

### Sfondi ekonomik

**Shkalla e papunësisë** në mostër është rreth 26 për qind për burrat dhe 31 për qind për gratë. Në mesin e burrave të punësuar, rreth 41 për qind e tyre punojnë në mënyrë joformale (p.sh. nuk kanë kontratë formale të punës). Burimi kryesor i të ardhurave në familje sigurohet kryesisht nga vetë respondentët burra (51%) ose nga prindërit e tyre. Vetëm 2 për qind e respondentëve burra thanë që partneret e tyre siguronin burimin kryesor financiar në shtëpi. Në anën tjetër, 55 për qind e grave deklaruan që partnerët e tyre sigurojnë burimin kryesor të të ardhurave në familjen e tyre. Të ardhurat mesatare në një familje ishin 565 euro (i mesëm 450), ndërsa të ardhurat personale ishin mesatarisht 299 euro (i mesëm 278) dhe 188 euro (i mesëm 161 euro) për gratë.




Figura 1 – Burimi kryesor i të ardhurave për gratë dhe burrat që jetojnë me familjarë të tjerë



### 3.2. Normat dhe qëndrimet gjinore ndaj barazisë gjinore

Kjo pjesë fokusohet direkt në opinionet e burrave dhe grave lidhur me barazinë gjinore. Kjo e fundit matet përmes deklaratave të ndryshme që portretizojnë si perceptimet e barazisë ashtu edhe ato të jobarazisë për normat dhe raportet gjinore. Shkallët apo normat e vetë-deklaruara të dakordimit kanë qëllim të kapin normat e zakonshme që shërbejnë si drejtim për burrat dhe gratë në Kosovë. Këto norma kuantifikohen në shkallë metrike të njohur si shkalla matëse e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore (në tekstin me poshtë GEM). Pas pasqyrës së përgjithshme të normave dhe qëndrimeve gjinore në Kosovë, pjesët vijuese trajtojnë në hollësi sferat e ndryshme që lidhen me gjini të cilat mund të shërbejnë si blloqe ndërtuese për normat dhe qëndrimet mbizotëruese gjinore.

#### *Shkalla Matëse e Qëndrimit të Burrave ndaj Barazisë Gjinore*

Shkalla matëse e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore bazohet në **perspektivën shoqërore të normave gjinore**<sup>28</sup>. Me këtë nënkuptohet që kultura e shoqërisë vendos apo përcakton mënyrën e duhur apo mënyrat e duhura të sjelljes, të menduarit dhe vepruarit për gratë dhe burrat. Kjo bëhet përmes një sërë kanalesh, siç janë normat që barten në familje dhe/ose institucione. Megjithatë, këto standarde jo vetëm që pranohen, ato gjithashtu përvetësohen, rikrijohen dhe më pas barten tek të tjerët<sup>29</sup>. Korniza konceptuale e shkallës matëse të qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore fokusohet në modele të burrërisë apo maskulinitetit që buron nga shoqëria, por që mund të kenë nivele të ndryshme për grupe të veçanta të njerëzve. Ajo gjithashtu përpiqet të inkorporojë raportet e pushtetit që ekzistojnë në normat gjinore<sup>30</sup>. Objektivi kryesor i shkallës është të **masë qëndrimet ndaj normave gjinore në marrëdhëniet intime** ose pritshmëritë e ndryshme të shoqërisë për gratë dhe burrat. Në studimet e mëhershme, është provuar të parashikohen rezultatet e ndryshme që ndërlidhen siç është përdorimi i prezervativëve, kontraktivëve ose dhuna e partnerit<sup>31</sup>.

Për Kosovë shkalla përbëhet prej **15 nga 24 pyetjet** e metodologjisë së shkallës për matjet e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore (shih tabelën 3). Pas kryerjes së testit të besueshmërisë, është vendosur që të përfshihen të gjitha pyetjet për ndërtimin e shkallës (bazuar në rezultatet e konsistencës së brendshme Cronbach Alpha). Në pyetjet ku nuk është marrë përgjigje është shënuar mungon, për të mos prishur apo paragjykuar shkallën matëse. Opsionet: nuk pajtohem, pajtohem pjesërisht dhe pajtohem plotësisht janë vlerësuar me notë 1, 2 dhe 3 respektivisht. Vetëm njëra pyetje ka implikime pozitive për barazinë gjinore, kështu që përgjigjet janë koduar për notim të kundërt për njëtrajtshmëri në peshim për çdo kategori përgjigjesh. Shkalla matëse e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore u llogarit si shumë e vlerësimeve (notave) për çdo deklaratë. Më pas, ajo u nda trefish në “Barazi e lartë”, “Barazi e moderuar” dhe “Barazi e ulët” duke e ndarë në tre pjesë të barabarta. Shtrirja bazohet në të tretat e gamës së notave të mundshme. Shtrirja për shkallën tonë të Qëndrimit të Burrave ndaj Barazisë Gjinore ishte: Barazi e ulët 15-24; Barazi mesatare 25-34; Barazi e lartë 35-45.

<sup>28</sup> Kimmel, M. S. (2011). *Shoqëria gjinore* (botimi i 4). Nju Jork: Oxford University Press.

<sup>29</sup> Barker, G., Contreras, J., Heilman, B., Singh, A., Verma, R., & Nascimento, M. (2011). *Burri evolues: rezultatet fillestare nga Anketat e bëra Ndërkombëtare mbi Burrat dhe Barazinë Gjinore (IMAGES)*. Qendra Ndërkombëtare për Hulumtime për Gruan (ICRW) dhe Instituti Promundo.

<sup>30</sup> Pulerwitz, J., & Barker, G. (2008). Matja e qëndrimeve ndaj normave gjinore dhe burrave të rinj në Brazil: zhvillimi dhe Vlerësimi Psikometrik i Shkallës GEM. *Burra dhe maskuliniteti*, 1(3), 322-338.

<sup>31</sup> Singh, A., Verma, R., & Barker, G. (2013). *Matja e Qëndrimit Gjinor: Përdorimi i shkallës për matjen e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore (GEMS) në suaza të ndryshme Socio-Kulturore*. UN Women.

Tabela 3 – Rezultat e burrave për çdonjërën nga 15 pyetjet e Shkallës matëse të qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore

	Nuk pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Pajtohem plotësisht	Pa përgjigje
1. Gruaja duhet ta tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen e bashkuar.	67.9	21.0	7.1	4.0
2. Ka raste kur gruaja vërtetë e meriton të rrahet.	54.5	32.7	8.7	4.1
3. Do të zemërohesha shumë nëse gruaja do të më kërkonte të përdor prezervativ.	52.6	23.8	12.1	11.4
4. Është përgjegjësi e gruas t'i shmanget apo të ruhet nga shtatzënia.	45.7	35.5	8.8	10.1
5. Burrat nuk flasin për seksin; ata thjesht e bëjnë.	32.6	44.9	17.3	5.1
6. Burrat kanë nevojë për marrëdhënie seksuale më shumë se gratë.	31.9	39.7	23.3	5.1
7. Burrave duhet t'ju vijë turp nëse nuk janë në gjendje të kenë ereksion gjatë marrëdhënies seksuale.	31.5	30.6	24.4	13.5
8. Për të qenë burrë, duhet të jesh i ashpër.	27.9	34.4	33.3	4.4
9. Burri duhet ta ketë fjalën e fundit për vendimet në shtëpi.	26.3	40.6	28.9	4.3
10. Burrat janë gjithmonë të gatshëm për marrëdhënie seksuale.	25.7	36.2	32.7	5.4
11. Roli më i rëndësishëm i gruas është të kujdeset për shtëpinë dhe të gatuj për familjen.	25.7	40.7	32.1	1.5
12. Ndërrimi i pelenave, larja e fëmijëve dhe ushqyerja e fëmijëve janë përgjegjësi e gruas.	25.4	35.8	36.7	2.2
13. Nëse dikush më ofendon, do ta mbrojtë reputacionin tim edhe me forcë nëse duhet.	21.8	32.4	40.3	5.5
14. Kurrë nuk do ta kem shok dikë që është gej.	17.9	17.0	55.4	9.7
15. Gruaja dhe burri duhet të vendosin së bashku për llojin e kontraceptivit që duhet të përdorin.	11.8	24.0	59.4	4.8

Shkalla e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore kryesisht përqendrohet tek burrat, siç tregon edhe vetë emri i saj, por është llogaritur edhe për gratë në mënyrë që të tregojë dallimet në qëndrime ndaj normave gjinore në mes këtyre dy grupeve. Figura 2 tregon se shumica e burrave dhe e grave janë brenda normave mesatare të barazisë. Megjithatë, një pjesë e **konsiderueshme e burrave kanë shfaqur barazi të ultë** në vlerë 13 për qind, kundrejt vetëm 1 për qind të grave që hyjnë në këtë kategori.

### SHKALLA E GEM PËR BURRAT DHE GRATË




Figura 2 – Shkalla e GEM për burrat dhe gratë

### SHKALLA E GEM PËR BURRAT SIPAS GRUP-MOSHËS




Figura 3 – Shkalla e GEM për burrat sipas grup-moshës

“Kur edhe vetë gratë pranojnë norma shtypëse, kjo tregon që nuk janë vetëm burrat që shfaqin karakteristika patriarkale. Sistemi Patriarkal i shtyp edhe burrat, por ju jep edhe privilegje. Duke qenë të shtypura, gratë janë shpesh kujdestare fanatike të moralit patriarkal, jo vetëm pse janë të socializuara në këtë sistem, por edhe si mënyrë për të mbijetuar.

Elife Krasniqi, kandidate për Ph.D. Universiteti i Gracit, Austri

Janë kryer edhe teste shtesë për ta kuptuar më mirë arsyen përse disa burra ishin më kundërshtues apo më të prirur ndaj barazisë gjinore. Në pamje të parë, figura 3 tregon që **grup-moshat e reja kanë treguar barazi më të lartë në norma gjinore se sa grup-moshat më të vjetra**. Ka dëshmi në këto të dhëna që flasin për **dallim gjeneratash sa i përket normave të barazisë gjinore** në mesin e burrave në Kosovë.

Bazuar në intervistat e thukëta të zhvilluara me përfaqësues të institucioneve relevante dhe organizatave qeveritare, pavarësisht rezultateve premtuese, gjeneratat e reja janë ende nën ndikimin e normave tradicionale. Për shembull, gjatë punës së saj me shkollat publike në Kosovë, Vetone Veliu, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Grave të Mitrovicës për të Drejta të Njeriut ka vërejtur që madje edhe djem të moshës 12 vjeçare do të ishin kategorikisht kundër asaj që motrat e tyre të trashëgonin pjesë të pasurisë familjare duke e pasur parasysh që ato do të martohen kur të rriten.

Analiza e mëtejshme e shkallës së qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore ka treguar që, në mesin e burrave, karakteristikat e tjera socio-ekonomike përkonin me nivelin e barazisë. Për shembull, burrat me shkollim më të ulët shfaqin gjithashtu shkallë më të lartë të barazisë së ulët në norma gjinore. Vërtetë, testet e rëndësishme statistikore kanë gjetur se shkollimi korrespondon në mënyrë të konsiderueshme me nivelin e shkallës së qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore me interval besueshmërie prej 99 për qind. Një gjetje interesante është se niveli i shkollimit të burrave jo vetëm që është relevant për normat që i përqafojnë, por **rol të madh luan edhe niveli i shkollimit të prindërve**. Figura 4 tregon se sa ma i lartë të jetë niveli i shkollimit të nënës dhe babait, aq më i lartë është vlerësimi në shkallën e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore. Rezultatet ishin të konsiderueshme me interval besueshmërie prej 99 për qind.

### SHKALLA GEM PËR BURRAT SIPAS SHKOLLIMIT TË PRINDËRVE




Figure 4 – Shkalla e GEM për burrat sipas shkollimit të prindërve

### SHKALLA GEM DHE TË ARDHURAT PERSONALE




Figure 5 – Shkalla GEM dhe të ardhurat personale

Po ashtu, u pa që si të ardhurat personale ashtu edhe ato familjare përkonin pozitivisht me shkallën e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore në interval besueshmërie prej 99 për qind. **Sa më të larta fitimet, aq më shumë gjasë kishte që burrat t'i përfaqonin normat e barazisë gjinore.** Figura 5 i tregon fitimet personale mesatare në çdo kategori të shkallës së qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore për burrat. Gjatë shqyrtimit të dallimeve në norma ndërmjet vendbanimeve, të dhënat nuk treguan ndryshim apo dallim të konsiderueshëm në mes normave të atyre që jetojnë në zona rurale kundrejt atyre në zona urbane. Migrimi i lartë në drejtim të zonave urbane pas konfliktit në Kosovë mund ta ketë vështirësuar dallimin ndërmjet njerëzve që vijnë nga sfondi rural apo urban.

Figura 6 shfaq **opinionet e burrave në deklarata të caktuara** që i ballafaqojnë të drejtat e grave me ato të burrave. Rreth 20 për qind e burrave përgjithësisht ndanin mendimin që kur gratë punojnë ato ua marrin burrave ato vende pune. Një pjesë goxha e madhe e burrave i vlerësuan çështjet e barazisë gjinore si një lojë pa fitues. Për shembull, rreth 16 për qind besojnë se kur gratë fitojnë të drejta, janë burrat që humbasin nga kjo. Ngjashëm, 13 për qind e burrave gjithashtu u pajtuan me deklaratën se më shumë të drejta për gratë nënkupton më pak sosh për burrat. Të këtij mendimi janë, pak a shumë, edhe gratë respondente; numri i grave që nuk pajtohet me këto deklarata është paksa më i lartë se ai i burrave. Natyrisht, burrat me qëndrim më pozitiv ndaj barazisë gjinore, siç është matur nga shkalla e qëndrimit të burrave ndaj barazisë gjinore, me shumë gjasë mund të mos pajtohen me deklaratat që e portretizojnë barazinë gjinore si lojë pa fitues. Megjithatë, shumica e burrave besojnë që çështja e barazisë gjinore është adresuar tashmë në shoqërinë tonë. Rreth 59 për qind e burrave pajtohen me deklaratën se barazia gjinore, pra barazia mes burrave dhe grave, kryesisht është arritur në shoqërinë tonë.

## MENDIMI PËR TË DREJTAT E GRAVE




Figura 6 – Mendimi i burrave për të drejtat e grave

*Qëndrimet ndaj diversitetit seksual*

Qëndrimet ndaj diversitetit seksual janë të lidhura ngushtë me normat shoqërore të një shoqërie. Sa më konservatore të jetë shoqëria, aq më pak janë njerëzit e hapur për t'i pranuar njerëzit me orientime seksuale dhe/ose identitete gjinore jokonvencionale. Për shembull, ashtu siç thekson Besa Luci, kryeredaktore e Kosova 2.0, në intervistën e saj që është pjesë e këtij hulumtimi, qëndrimet homofobike burojnë nga përkufizimet shoqërore dhe individuale se si duhet të jetë një burrë apo grua. Kur qëllimi i vetëm i jetës së një gruaje është riprodhimi, atëherë format e tjera të seksualitetit domosdoshmërisht konsiderohen devijime nga qëllim i jetës së saj. Tutje, ajo sqaron se si njerëzit në shoqërinë tradicionale të Kosovës ende operojnë si bashkësi e jo si individ, që e bënë të pamundur të kuptuarit dhe pranimit të zgjidhjeve individuale të stilit jetësor dhe, veçanërisht, preferencave seksuale. Rrjedhimisht, barazia gjinore është shumë më e gjerë se sa ajo ndërmjet burrave dhe grave.

“*Pabarazia gjinore nuk i referohet vetëm dallimeve në rolet e burrave dhe grave. Kjo është një prej gabimeve më të mëdha që bëjnë institucionet dhe shoqëria civile që në fillim të luftës për barazi gjinore.*”

Blert Morina, Menaxher Programi Qendra për Barazi dhe Liri Prishtinë

Figurat 7 dhe 8 i tregojnë opinionet e burrave dhe grave lidhur me deklaratat mbi homoseksualitetin. Mund të shohim se shumica e burrave prirën të pajtohen me deklaratat negative, të cilat shprehin mospëlqim ndaj diversitetit seksual. Të dhënat për gratë tregojnë një reagim më të butë ndaj homoseksualitetit. Për shembull, rreth 74 për qind e burrave pajtohen me deklaratën që personat gej apo lezbik nuk duhet lejuar të punojnë me fëmijë, krahasuar prej 41 për qind pajtueshmëri tek gratë. Në linjë të ngjashme mendimi, nivelet e pajtueshmërisë tek burrat dhe gratë janë të ulëta edhe në deklaratat pozitive rreth homoseksualitetit. Për shembull, 67 për qind e burrave dhe 55 për qind e grave nuk pajtohen që homoseksualiteti të konsiderohet si diçka e natyrshme dhe normale. Për më tepër, 60 për qind e burrave dhe 46 për qind e grave besojnë që çiftet gej apo lezbike nuk duhet lejuar të martohen ligjërisht si çiftet heteroseksuale. Vlen të theksohet që, në të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me diversitetin seksual, gratë kanë refuzuar të përgjigjen më shumë se sa burrat.

### MENDIMET PËR DIVERSITETIN SEKSUAL




Figura 7 – Mendimet e burrave dhe grave për diversitetin seksual

### MENDIMET PËR DIVERSITETIN SEKSUAL




Figura 8 – Mendimet për diversitetin seksual

Analiza e mëtejshme e opinionëve të burrave dhe normave të tyre gjegjëse gjinore zbulon që burrat që shfaqin qëndrim më të lartë për barazi gjinore prirën të jenë më tolerantë dhe më pranues ndaj diversitetit seksual. Opinionet për homoseksualitetin nuk dallojnë në esencë ndërmjet grup-moshave të ndryshme. Për më tepër, kur shohim shkallën e pranueshmërisë së homoseksualitetit tek etnitë e ndryshme vërejmë që të dhënat nuk ofrojnë prova për ndonjë ndryshim substancial në mënyrën e të menduarit.

### Qëndrimet ndaj seksit transaksional

Pjesa e fundit e kapitullit për normat gjinore përfshin një pjesë të veçantë për qëndrimet ndaj **seksit transaksional**. Derisa puna si punëtore seksi është e jashtëligjshme në Kosovë, seksi transaksional është term më i gjerë, i cili përfshin angazhim në marrëdhënie seksuale për përfitime të tjera rrethore. Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet se si i shohin burrat dhe gratë këto praktika me qëllim të kuptimit të dinamikave ndërmjet gjinive. Mbizotërimi i seksit transaksional mund të mos bazohet në vullnetin e lirë të individëve. Hulumtimi në pjesë të tjera të botës ka treguar se angazhimi në seks transaksional shpesh shoqërohet nga statusi socio-ekonomik, përvoja të këqija në fëmijëri, më shumë parterë seksualë gjatë jetës, dhe përdorim të alkoolit<sup>32</sup>. Veç kësaj, dhuna e bazuar në gjini është shoqëruar vazhdimisht dhe në mënyrë domethënëse me seksin transaksional<sup>33</sup>. Prandaj, kjo praktikë lidhet ngushtë me ushtrimin e kontrollit dhe pushtetit gjinor nga burrat.

Figura 9 më poshtë paraqet dhe krahason përgjigjet ndërmjet burrave dhe grave respondente për opinionin e tyre për **gratë e rritura dhe të mitura që punojnë si punëtore seksi**. Burrat, për dallim prej grave, ka më pak gjasë ta konsiderojnë këtë veprim si moralisht të gabuar, madje edhe në rastin e vajzave të mitura. Gjithashtu, ata priren që zgjedhjen për këtë punë t'ia atribuojnë vetë punëtoreve të seksit më shpesh se sa gratë. Opinione të burrave dhe grave nuk dallojnë edhe aq shumë kur bëhet fjalë për burrat e rritur dhe të mitur që **punojnë si punëtor seksi**. Gjetjet paraqiten më poshtë në figurën 10.

### MENDIMET PËR SHËRBIMET SEKSUALE QË OFROHEN NGA GRATË




Figura 9 – Mendimet e burrave dhe grave për shërbimet seksuale të ofruara nga gratë

<sup>32</sup> Dunkle, K. L., Jewkes, R., Nduna, M., Jama, N., Levin, J., Sikweyiya, Y., & Koss, M. P. (2007). Seksi transaksional me partnerë të rastit dhe të rregullt në mesin e burrave të rinj nga Afrika Jugore në Kepin Lindor: Mbizotërimi, parashikuesit, dhe lidhjet me dhunën që bazohet në gjini. *Shkenca shoqërore dhe Mjekësia*, 65(6), 1235–1248.

<sup>33</sup> Po aty.

## MENDIMET PËR SHËRBIMET SEKSUALE TË OFRUARA NGA BURRAT





Figura 10 – Mendimet e burrave dhe grave për shërbimet seksuale të ofruara nga burrat

Shumica e burrave dhe e grave e konsiderojnë si moralisht të gabueshme që burrat të blejnë shërbime seksi, ashtu si tregohet në figurën 11. Rreth 21 për qind e burrave dhe 35 për qind e grave i konsiderojnë si (mendërisht) të sëmurë burrat që blejnë shërbime seksi. Blerja e shërbimeve seksuale në kohën kur nuk ekziston lidhje e rregullt me dikë tjetër arsyetohet më shpesh nga burrat (12 për qind) se sa nga gratë (4 për qind). Megjithatë, burrat përgjithësisht nuk pajtohen qoftë me blerjen apo me shitjen e shërbimeve seksuale. Më shumë se gjysma e tyre mendon se shitja apo blerja e shërbimeve seksuale duhet të jetë e kundërligjshme, pavarësisht nga mosha e punëtorëve të seksit.

### MENDIMI I GRAVE PËR BURRAT QË BLEJNË SHËRBIME SEKSUALE



### MENDIMI I BURRAVE PËR BURRAT QË BLEJNË SHËRBIME SEKSUALE




Figura 11 – Opinione e burrave dhe grave për burrat që blejnë shërbime seksuale

Përfundimisht, burrat dhe gratë u pyetën për përvojat e tyre me seksin transaksional. Të dhënat tregojnë që së paku një për qind e grave të intervistuar kishin përjetuar seks transaksional së paku një herë gjatë jetës së tyre, në një formë apo tjetër, dhe për arsye të ndryshme siç është sigurimi i një vendbanimi, pagesa e faturave, etj. Megjithatë, niveli i vetë-deklaruar i burrave për marrëdhënie seksuale transaksionale është paksa më i lartë se ai i deklaruar nga gratë. Së paku pesë për qind e burrave pohuan të kanë bërë seks vetëm një herë me ndonjë grua tjetër në këmbim të të mirave materiale që u kanë dhënë.



### 3.3. Përvojat e fëmijërisë

Rëndësia e përvojave të fëmijërisë për jetë të shëndoshë si i rritur është njohur nga organizatat dhe traktatet ndërkombëtare, por edhe nga hulumtimet shkencore. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të fëmijëve dhe thekson që “[...] fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi...”<sup>34</sup>.

Edhe në fushën e psikologjisë edhe në atë të neurologjisë, studimet kanë treguar që truri zhvillohet më shpejt në tri vitet e para të jetës, si dhe vitet e fëmijërisë mund të kenë implikime të mëdha tek vitet vijuese të zhvillimit<sup>35</sup>. Kështu, themelet e mendimeve, qëndrimeve, zakoneve e normave vendosen edhe para kujtimeve të para të njeriut. Normat gjinore nuk janë përjashtim, si dhe shpesh janë të dukshme nga formësimi familjar i vajzave dhe djemve brenda roleve specifike sipas gjinisë së tyre. Mund të fillojë nga gjëra të thjeshta, si ngjyrat e veshjes, e deri tek çështjet më themelore të llojit ambicieve apo pritjeve që instalohen brenda tyre. Një shembull tipik në Kosovë është që djemtë të mësohen të jenë të suksesshëm dhe krerë të familjes, derisa vajzave iu thuhet të martohen në familje të mira dhe të jenë amvise. Kjo normë është konfirmuar nga shumica e respondentëve gjatë intervistave të hollësishme që kanë theksuar rëndësinë e pritjeve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme nga shoqëria tek ndikimi i zgjedhjeve jetësore të vajzave dhe djemve të rinj. Mrika Aliu, drejtore ekzekutive e organizatës joqeveritare Veprimi për Nëna dhe Fëmijë, thekson në intervistën e saj se si edhe librat shkollorë, si dhe lëndët e përgjithshme shkollore, si edukata qytetare vendos role specifike gjinore dhe krijojnë profile të caktuara për burra dhe gra në jetën e tyre private (pra punët e shtëpisë) dhe publike (drejtimet e karrierës).

Një analizë e kryer më herët nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) në Kosovë ka theksuar gjithashtu që derisa kurrikula përmban tema të ndërthurura si çështjet gjinore dhe të drejtat e fëmijës, mungesa e trajnimit të mirëfilltë të mësimit mund të pengojë implementimin e plotë të kësaj qasjeje<sup>36</sup>. Një studim tjetër i kryer nga Qendra Arsimore e Kosovës, i cili përbëhet nga leximi dhe analiza e 323 librave shkollorë, ka gjetur që mbi 90 për qind të indikatorëve janë në favor të rolit dominues mashkullor, pra dominimi i burrave në figura e personazhe, që përkrah role të stereotipizuara për djem e vajza, por edhe për burra e gra<sup>37</sup>. Nga 323 libra shkollorë të trajtuar në studim, vetëm 45 përmendin gratë në role profesionale, krahasuar me 187 që përmendin burrat<sup>38</sup>.

Shembuj të tillë janë vetëm një prej mënyrave të drejtpërdrejta se si **normat gjinore formësohen që në moshë të hershme**. Ekzistojnë edhe mënyra të tërthorta, ose përmes sjelljes së prindërve mes vete, apo nga shoqëria, që ndikojnë tek mendimet për barazinë gjinore. Për të arritur barazinë afatgjate gjinore në shoqëri, është me rëndësi të kuptohen shtresat e ndikimeve të ndërsjella përmes njerëzve, komuniteteve e mjediseve. Në bazë të këtyre argumenteve, analiza vijuese mëton të ilustrtojë përvojat fëmijërore të burrave, si dhe se si ato lidhen me çështjet gjinore në Kosovë, nga këndvështrimi i burrave.

<sup>34</sup> Kombet e Bashkuara (1989). Konventa për të Drejtat e Fëmijës *Seritë e Traktateve, 1577*, 3. f. 45.

<sup>35</sup> Shonkoff, J.P. dhe Phillips, D.A. (2000). Nga neuronet e deri tek lagjet (From Neurons to Neighbourhoods:) Shkenca e zhvillimit të hershëm fëmijëror (The Science of Early Childhood Development). National Academy Press.

<sup>36</sup> Moo Sang, B., & Wenderoth, A. (2004). Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë (*Situational Analysis of Education in Kosovo*). UNICEF Kosovë.

<sup>37</sup> Hyseni, H., Lllunji, V., & Kabashi-Hima, A. (2007). Barazia gjinore në librat shkollorë gjatë nëntë viteve të arsimit të detyrueshëm në Kosovë (*Gender Equality in the Reading Textbooks During the Nine Years of Compulsory Education in Kosovo*). Qendra Arsimore e Kosovës / Instituti për Shoqëri të Hapur.

<sup>38</sup> Po aty.

**Ndarja e roleve mes prindërve** është njëra prej mënyrave në të cilat fëmija socializohet brenda normave specifike gjinore. Kujdesi për fëmijë kryesisht shihet si obligim i nënës sipas normave sociale në Kosovë. Rezultatet nga anketa tregojnë që 64 për qind të grave dhe 73 për qind të burrave ose pajtohen ose pajtohen pjesërisht që ndërrimi i pelenave, larja e fëmijëve, si dhe ushqimi i fëmijëve janë përgjegjësi e gruas. Kjo pjesërisht konfirmohet edhe nga përvojat e fëmijërisë së burrave në Kosovë, ku 35 për qind e tyre kanë pasur kujdes kryesisht ose vetëm nga nënat e tyre. Figura 12 më tutje tregon që një pjesë substanciale e tyre (59 për qind) kanë raportuar që kanë pasur kujdes gati të barabartë nga nëna dhe babai, por babai rrallëherë e merr përsipër i vetëm këtë detyrë.

Prindërit shpesh luajnë rolin e edukatorëve, me apo pa vetëdije, derisa kujdesen për fëmijët e tyre. Kështu, është me rëndësi të krijohet edhe pasqyra e **prapavijës arsimore** të tyre. Rezultatet nga anketa tregojnë që nënat e rreth 64 për qind të burrave nuk kanë përfunduar as shkollën e mesme, derisa kjo shifër është më e ulët për baballarët, me rreth 46 për qind.

Figurat dhe rezultatet vijuese i referohen **përvojave të burrave para se t'i mbushin 18 vjeç**. Për shembull, figura 13 tregon që rasti ku e ëma trajton të atin me respekt ka qenë pak më i theksuar se e kundërta. Figurat mashkullore rrallë janë parë të përgatisin ushqim apo të bëjnë punë të shtëpisë, pasi që këto zakonisht janë etiketuar si punë të grave. Figura 14 tregon që më se gjysma e respondentëve kurrë ose gati kurrë nuk kanë parë të atin apo ndonjë të afërm mashkull të bëjnë ato punë. Burrat që i përkasin grup-moshave më të reja kanë më shumë gjasë të kenë parë baballarët e tyre apo figura të tjera mashkullore që angazhohen aktivisht në detyrat e shtëpisë. Angazhimi më i madh shtëpiak i baballarëve të burrave apo figurave të tjera mashkullore ishte më i shpeshtë kur prindërit e respondentëve kishin shkollim të lart.



### SIGURUESI KRYESOR PË BURRAT GJATË FËMIJËRISË




Figura 12 - Kujdestari kryesor për burrat gjatë fëmijërisë

### TRAJTIMI NGA NËNA DHE BABAI

- Babai e ka trajtuar nënën time me respekt.
- Nëna e ka trajtuar babain tim me respekt.




Figura 13 - Raportet e burrave mbi trajtimin ndërmjet nënës dhe babait

### PUNËT E SHTËPISË NGA BABAI APO FIGURA TË TJERA MASHKULLORE TË BURRAVE NË SHTËPI GJATË FËMIJËRISË




Figura 14 - Punët e shtëpisë nga babai apo figura tjera mashkullore në shtëpi gjatë fëmijërisë

“Në përvojën time të punës, shpesh kam hasur në raste ku gratë nuk kanë mundur të vendosin vetë për arsimimin e fëmijëve të tyre pa aprovimin e dikujt që është i largët, si kunati në diasporë. Këta të fundit shpesh ofrojnë mbështetje financiare për familjet e gjera, si dhe pretendojnë të kenë të drejtë të vendosin për çështje të tilla të rëndësishme.

Veprorë Shehu  
Drejtores Ekzekutive  
Medica Kosova  
Gjakovë

Diskutimet në grup të fokusit gjithashtu kanë konfirmuar dhe kanë dhënë edhe shpjegime të mëtutjeshme për këto gjetje. Edhe gratë shqiptare edhe ato serbe të Kosovës që kanë marrë pjesë në grupet e fokusit kanë shpjeguar se si punët e shtëpisë janë parë si detyra joburrërore, të cilat do të ishin turpëruese për burrin nëse do t'i kryente. Ato gjithashtu kanë theksuar punësimet e rralla tek gratë në të kaluarën, gjë që natyrshëm ka kufizuar jetën e tyre brenda mureve të shtëpisë. Burrat që kanë marrë pjesë në grupet e fokusit kanë pasur më pak prirje t'i konsiderojnë punët e shtëpisë si joburrërore, por e kuptojnë nuancën gjinore të atyre detyrave. Pjesëmarrësit në grupe të fokusit kanë theksuar që ky mentalitet ka filluar të ndryshojë së voni, por mbetet e tij ende barten nga gjenerata në gjeneratë.

Edhe kur bëhet fjalë për **marrjen e vendimeve në familje**, ishte tejet e rrallë që nëna të kishte fjalën e fundit, ose edhe të barabartë, në vendimet për shpenzime në investime të mëdha, si blerja e një veture apo shtëpisë. Pjesëmarrësit burra në diskutim ishin më pak të bindur për të dhënat mbi mungesën e fuqisë së grave në vendimet në lidhje me ushqimin dhe veshmbathjet, pasi që i shohin ato si personat që e dinë më së miri se çfarë duhet në shtëpi. Megjithatë, siç thekson me të drejtë njëri prej tyre, edhe nëse mendimi i grave është marrë parasysh në ato çështje, fjala e fundit gati gjithmonë mbetet tek burrat e ekonomisë familjare. Ai është personi që “sjell bukën në tavolinë”, e si i tillë, ai është personi që do të vendosë se si do të shpenzohen paratë.

Kur merret parasysh niveli arsimor i prindërve, pjesa e burrave që i kanë pasur edhe nënat edhe baballarët të angazhuar njëjloj në vendime të rëndësishme për familjen dhe shtëpinë rritet në masë të konsiderueshme, sidomos kur nëna dhe/ose babai ka së paku një titull universitar. Duhet theksuar që edhe kur nëna është e diplomuar nga universiteti, pjesa e rasteve kur ajo ka pasur fjalën e fundit mbetet tejet e ulët (shtatë për qind të vendimeve për fëmijë, 16 për qind të vendimeve për shpenzim të parave për ushqim dhe veshmbathje, si dhe katër për qind tek vendimet për shpenzimet e parave në investime të mëdha). Kështu, edhe për popullatën më të edukuar të Kosovës, është ende relativisht e pazakonshme që gratë të kenë fjalën e fundit për vendimet në lidhje me familjen dhe shtëpinë e tyre.

## GJATË FËMIJËRISË SË DJEMVE, KUSH E KA PASUR FJALËN E FUNDIT PËR:




Figura 15 - Raportet e burrave mbi vendim-marrjen e prindërve gjatë fëmijërisë

Përvojat e fëmijërisë nuk përmbajnë vetëm vrojtime pasive të sjelljeve të prindërve dhe mënyrës së menaxhimit të ekonomisë familjare, por edhe të asaj që vetë individët përjetojnë në mënyrë aktive derisa rriten. Për shembull, derisa detyrat e shtëpisë ishin kryesisht detyra të nënave, më se gjysma e **respondentëve burra në fakt janë mësuar të përgatisin ushqim** (52 për qind) dhe të kujdesen për vëllezërit e motrat e tyre (71 për qind). Por, pastrimi i shtëpisë (44 për qind) apo larja e rrobave të tyre (25 për qind) janë mësuar më rrallë nga ta. Burrat me prindër më të arsimuar kanë pasur më shumë gjasë të mësohen të bëjnë shumicën e detyrave të përmendura. Për shembull, 79 për qind të burrave, nënat e të cilëve kanë përfunduar së paku universitetin, iu është mësuar përgatitja e ushqimit, kundrejt 35 për qind të burrave nënat e të cilëve nuk kanë pasur shkollim. Këto trende ndjekin vijën e ngjashme edhe me nivelin arsimor të babait. Kështu, këto gjetje tregojnë që arsimimi prindëror luan rol të rëndësishëm në të mësuarit e burrave në moshë të hershme që të angazhohen më shumë në shtëpi. Mosha nuk luan ndonjë rol tek pyetja nëse burrat janë mësuar të marrin përsipër detyrat e shtëpisë, përveç përgatitjes së ushqimit: burrat më të rinj kanë shumë më shumë gjasë të kenë mësuar të përgatisin ushqim sesa burrat më të moshuar.

**Ekspozimi ndaj praktikave abuzuese**, si dhuna, përdhunimi apo dehja, është regjistruar në anketë, pasi është element i pashmangshëm në mirëqenien psikologjike të fëmijës në atë moment kohor, por edhe në të ardhmen. Përvojat e dhunës fizike apo psikologjike gjithashtu lënë një vragë të dukshme tek karakteri dhe pikëvështrimi i personit mbi botën. Rezultatet nga anketa paraqesin një situatë alarmuese. Gjetjet tek figura 16 tregojnë që nëntë për qind të respondentëve burra shpesh janë ndëshkuar fizikisht ose në shtëpi ose në shkollë, ose të dyja. Ata që kanë përjetuar dhunën e tillë kanë pasur gjithashtu më shumë gjasë të kenë averzion ndaj barazisë gjinore, siç mund të shihet nga korrelacioni me shkallën e burrave me barazi gjinore. Burrat që i përkasin grup-moshave më të reja kanë pasur më shumë gjasë që të mos jenë rrahur apo goditur në shtëpi. Kjo paraqitet serish tek ata burra me prindër me nivele më të larta arsimore.


**DHUNA E PËRJETUAR NGA BURRAT NË SHTËPI DHE SHKOLLË**

Figura 16 - Raportet e burrave mbi dhunën e përjetuar në shtëpi dhe shkollë gjatë fëmijërisë

Përvojat aktive dhe pasive të dhunës zgjerohen drejt formave më ekstreme për një numër substancial të të anketuarve. Rreth 20 për qind të burrave kanë dëgjuar së paku një herë nënën e tyre të jetë rrahur nga babai apo partneri i saj. Rastet e tilla kanë qenë më të shpeshta tek burrat, prindërit e të cilëve kanë pasur arsim të dobët (pra pa shkollim) ose tek gjeneratat e vjetra. Figura 17 më tutje tregon që 11 për qind të burrave së paku një herë kanë përjetuar situatën ku njëri apo të dy prindërit kanë qenë aq të dehur apo të droguar sa që nuk kanë mundur të kujdesen për ta. Një rezultat edhe më brengosës është që rreth tetë për qind të burrave kanë pranuar të kenë bërë seks së paku një herë për shkak se kanë qenë të kërcënuar, të frikësuar apo të detyruar.


**DHUNA E PËRJETUAR NË SHTËPI NGA BURRAT**

Figura 17 - Raportet e burrave mbi dhunën e përjetuar në shtëpi dhe shkollë gjatë fëmijërisë

Format e ndryshme të **dhunës në shkollë** dhe hapësirat tjera publike ndaj të cilave fëmijët janë ekspozuar ishin gjithashtu mjaft të përhapura. Rreth 40 për qind të burrave pranojnë që ka pasur bullizëm, ngacmime dhe bezdisje në shkollë apo në lagjet ku janë rritur. Një pjesë e ngjashme (39%) kanë raportuar të jenë ngacmuar apo bezdisur vetë nga të tjerët, si dhe rreth 33 për qind ia kanë bërë dikujt tjetër këtë. Për më tepër, 30 për qind të respondentëve burra gjithashtu theksojnë të kenë qenë së paku një herë pjesë e një grupi që do të luftonte me grupet tjera rivale në shkollë. Dhuna shpesh ka kaluar pa ndëshkim në shkolla, pasi që 65 për qind e burrave kanë thënë që janë ndëshkuar për bullizëm fizik ndaj fëmijëve tjerë. Sjelljet tjera të dëmshme të vetë-deklaruara, si përdorimi i drogave, nuk kanë qenë tejet të përhapura në shkolla. Rreth 87 për qind të respondentëve burra theksonin që nuk kishin marrë kurrë droga në shkollë.

Një analizë më e thellë e faktorëve të ngacmimeve të tilla tregon që përvojat në shtëpi janë të ndërlidhura me këtë çështje. Çështja e të qenit i ngacmuar, por edhe ngacmimit të të tjerëve, është krahasuar e ndërlidhur me përjetimin e dhunës në shtëpi, si të qenit i rrahur apo i pranishëm gjatë rrahjes së nënës. Ata që kanë përjetuar rrahje apo goditje në shtëpi së paku një herë kanë pasur më shumë prirje të jenë ngacmuar në shkollë sesa ata që kurrë nuk kanë përjetuar këtë lloj dhune në shtëpi. Rreth 47 për qind të atyre që janë rrahur apo goditur në shtëpi së paku një herë, gjithashtu kanë përjetuar ngacmim e bezdisje në shkollë. Kjo shifër bie në 16 për qind për respondentët burra që nuk kanë përjetuar dhunë të tillë në shtëpi. Ky raport vllente edhe për ngacmimin e të tjerëve. Respondentët që kanë parë dhunë ndaj nënës së tyre kanë pasur më shumë prirje të ngacmojnë të tjerët sesa ata që nuk kanë parë dhunë; 29 për qind të respondentëve burra që nuk kanë parë kurrë nënën duke u rrahur kanë ngacmuar të tjerët, në krahasim me 54 për qind të atyre që kanë qenë dëshmitarë, ndonjëherë apo edhe më shpesh, të dhunës në familje. Këto gjetje tregojnë që **prania e dhunës në moshë të hershme e normalizon dhunën si mjet ndërveprimi me të tjerë** në formë të pranimit të dhunës mbi veten por edhe të ushtrimit të dhunës ndaj të tjerëve.



### 3.4. Dinamika e marrëdhënieve dhe punët e shtëpisë

Një pjesë e pabarazisë gjinore ndodh në sferën private, në mënyrën se si zhvillohen marrëdhëniet dhe jeta e përbashkët mes partnerëve. Marrëdhëniet e pushtetit mund të diktojnë **ndarjen e detyrave** si dhe nxitjen e disa roleve që e kufizojnë gruan brenda shtëpisë dhe jashtë procesit të vendimeve të rëndësishme si në sferën publike ashtu edhe atë private. Raporti kryesor i organizatës “UN Women” mbi progresin e grave të botës zbulon që në të gjitha rajonet, gratë punojnë më shumë se burrat: ato bëjnë gati dy herë e gjysmë më shumë punë të papaguara në kujdes dhe punë shtëpiake, si dhe nëse kombinohen puna e paguar dhe ajo e papaguar, gratë në gati të gjitha vendet punojnë me orar më të gjatë sesa burrat çdo ditë<sup>39</sup>. Edhe në ekonomitë e zhvilluara, shumica e punëve të shtëpisë, që janë punë e papaguar, janë detyrim i gruas<sup>40</sup>. Edhe kur burrat përpiqen të marrin përsipër punë të shtëpisë, kryesisht është gjest i ndihmës e jo marrje përsipër e përgjegjësisë. Kështu, **ekonomia familjare mbetet domen i gruas**. Një karakteristikë tjetër e punëve të shtëpisë, detyrim i nënkuptuar për gra ky, është që nuk paguhen, e kështu, nuk llogariten në terma ekonomikë, si Bruto-Prodhi Vendor (BPV). Në Kosovë, edhe më shumë se në vende të tjera, gratë mbulojnë shërbime të konsiderueshme pa pagesë, si kujdesi për fëmijë, të moshuar dhe anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara.

Ky nën-kapitull përpiqet të japë një ilustrim të çështjeve të diskutuara më sipër përmes të dhënave të mbledhura në këtë hulumtim. Pas analizimit të përvojave mesatare fëmijërore të burrave në Kosovë (nën-kapitulli 3.3), paragrafët vijues fokusohen tek sjellja dhe raportet e tyre aktuale me barazinë gjinore në shtëpi. Ky përfshin dinamikën e raporteve me partneret dhe fëmijët e tyre, ndarjen e detyrave të shtëpisë si dhe marrjen e vendimeve. Duke marrë parasysh që ky kapitull përqendrohet kryesisht tek dinamika e marrëdhënieve në shtëpi, rezultatet e prezantuara këtu vlejnjë vetëm për ata që kanë deklaruar të kenë partnere dhe jetojnë me to.

Rreth 58 për qind të respondentëve burra deklarojnë të kenë partnere të rregullta apo stabile, ndërsa rreth 51 për qind të tyre thonë që bashkëjetojnë me partneren e tyre. Në bazë të rezultateve të anketës, ose respondentit mashkull është me shkollim më të lartë sesa partnerja e tij, ose e kanë të njëjtin **nivel arsimor**. Në vetëm 10 për qind të rasteve, partneret kanë qenë më të shkolluara sesa respondentët burra. Trendët gjinorë në regjistrimin e arsimit të lartë kanë ndërruar në vitet e fundit, pasi gratë shpesh përbëjnë pjesën më të madhe të studentëve në universitetet publike dhe private. Megjithatë, edhe pse përditë e më shumë gra regjistrohen në universitete, realiteti post-universitar zbulon dallimet në zgjedhjet jetësore mes burrave dhe grave, siç theksohet në intervistën me kryeredaktoren e revistës Kosovo 2.0, Besa Luci. Martesa dhe krijimi i familjes janë pritje edhe për burrat edhe për gratë, por të parët i bëjnë prioritet karrierën dhe paratë, derisa të fundit fokusohen tek fëmijët dhe ekonomia familjare. Kështu, potenciali i rritur i grave për shkak të rritjes së regjistrimeve në arsim të lartë shpesh kalon i pashfrytëzuar.

**Statusi ekonomik** i këtyre çifteve gjithashtu është tejet i pabarabartë. Vetëm 18 për qind e burrave kishin partnere të punësuar, formalisht apo joformalisht. Për më tepër, 62 për qind e burrave thoshin që partnerja e tyre asnjëherë nuk kishte punuar. Në bazë të këtyre dallimeve, pritet që të ketë një hendek mes të ardhurave brenda çiftit. Rezultatet e anketës në fakt ofrojnë prova që tregojnë se është shumë më e mundshme që partneri mashkull të fitojë të ardhura më të larta sesa partnerja. Rreth 41 për qind e respondentëve burra deklarorin të fitojnë shifra më të larta sesa partneri i tyre, në krahasim me rreth 21 për qind të atyre që thoshin të kundërtën.

<sup>39</sup> Sen, G. (2016). Progresi i grave të botës 2015–2016: Transformimi i ekonomive, realizimi i të drejtave (Transforming economies, realizing rights). Politikat sociale globale (*Global Social Policy*), 16(1), 94-96.

<sup>40</sup> Cichon, R. 2014. Rrugë e gjatë deri në barazi (A Long Way to Go Towards Equality:) Vlerësim shifrash për dallimet në të ardhurat jetësore të ndara në gjini në vende të caktuara evropiane (An Actuarial Estimation of Gender Specific Lifetime Income Gaps in Selected European Countries). Punim mbështetës për raportin Progresi i grave të botës 2015–2016: UN Women.

Përveç trendëve të vendim-marrjes në familjet e respondentëve burra, studimi gjithashtu përmban informata mbi mënyrën se si familjet e tyre aktuale menaxhojnë **vendim-marrjen**. Figura 18 tregon që kur bëhet fjalë për vendim-marrjen për investimet e mëdha, rreth 34 për qind thonë që janë vetë vendim-marrës. Derisa vërtetë është më e mundshme që të vendosin bashkë me partneren edhe për çështje të tjera, një gjetje interesante është që hisja e burrave që thonë se gruaja apo partnerja e tyre ka fjalën e fundit është tejet e ulët. Dallimet në prapavijën arsimore dhe ekonomike brenda çiftit mund të kenë ndikim në atë se kush ka fjalën e fundit në shtëpi për vendimet e rëndësishme. Diskutimi në grupet e fokusit me burra edhe gra thekson këtë argument. Të dy gjinitë besojnë që kohët po ndryshojnë, si dhe përditë e më shumë çifte po vendosin bashkë, e sidomos ata që janë më të shkolluar.

### VENDIM-MARRJA NË FAMILJE PËR SHPENZIMIN E PARAVE






Figura 18 – Raportet e burrave mbi vendim-marrjen në familje për shpenzimin e parave

### VENDIMET PËR SHPENZIMIN E PARAVE NË USHQIM DHE VESHMBATHJE: ATËHERË DHE SOT



### VENDIMET PËR SHPENZIMIN E PARAVE NË INVESTIME TË MËDHA: ATËHERË DHE SOT



Rregullimi i marrëdhënieve grua-burrë mund të lidhet me **përvojat fëmijërore të burrave**. Për shembull, kur shohin nënën në rol aktiv në vendim-marrje, kjo mund të ketë zhvilluar norma përfshirëse gjinore brenda tyre, gjë që pastaj shprehet në mënyrën në të cilën familja e tyre organizohet. Të dhënat ofrojnë disa prova për këtë hipotezë. Figurat 19 dhe 20 zbulojnë që burrat, prindërit e të cilëve kanë barazi në vendimet e rëndësishme familjare, kanë më shumë prirje të vendosin bashkërisht me partneret e tyre në çështjet e njëjta. Variablat tjera të rëndësishme, si arritshmëria arsimore e burrave dhe prindërve të tyre, nuk janë vërtetuar të kenë korrelacion të rëndësishëm me barazinë gjinore në vendim-marrje.

Figurat 19 dhe 20 – Raportet e burrave mbi vendim-marrjen mes prindërve mbi shpenzimet



Përveç vendim-marrjes në familje, as ndarja e detyrave nuk është e barabartë mes partnerëve, siç paraqitet në figurën 21. **Punët e shtëpisë**, si pastrimi dhe gatimi, janë gati ekskluzivisht domen i partneres, sipas përgjigjeve të burrave. Blerja e ushqimeve më shpesh ndahet si obligim. Detyrat tjera që shpesh shihen si obligime të burrit, si riparimet në shtëpi dhe pagesa e faturave, edhe në realitet më shpesh kryhen nga burrat. Derisa në vendim-marrje përvojat e fëmijërisë kanë pasur rëndësi, nuk kemi gjetur ndërlidhje ndërmjet prirjeve për ndarje të detyrave mes prindërve të burrave dhe prirjeve në familjet e tyre aktuale.




Figura 21 - Ndarja e detyrave të shtëpisë ashtu si raportohet nga burrat

“Derisa nuk ka barazi gjinore në shtëpi, nuk mund të ketë asnjëherë barazi gjinore në publik.”

Nicole Farnsworth  
Menaxhere Programi  
Rrjeti i Grave të Kosovës

Gjithashtu, nuk ka ndonjë dallim të madh mes grup-moshave të ndryshme, respondentëve burra dhe prapavijës arsimore të prindërve, si dhe shkallës së burrave me barazi gjinore. Përjashtim ishte detyra e pastrimit në shtëpi. Burrat që kishin notë më të lartë në shkallën e burrave me barazi gjinore kishin më shumë prirje të kryenit këtë detyrë bashkë me partneren e tyre, në krahasim me ata me notë më të ulët në shkallën e burrave me barazi gjinore.

Këto profile gjinore të burrave dhe grave kanë rrënjë të thella në elemente të ndryshme të shoqërive tona, sipas intervistave me palët e përfshira nga organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e barazisë gjinore. Përveç pritjeve që instalohen tek fëmijët nga prindërit e tyre, edhe sistemi arsimor konsiderohet të jetë faktor kyç në ngulitjen e ambicieve të njëjta gjinore tek vajzat dhe djemtë. Kjo bëhet përmes pritjeve paragykuese të mësuesve apo edhe librave shkollorë që përmbajnë nuanca gjinore. Ndikimi i mentalitetit patriarkal dhe arsimit mund të vërehet në diskutimet në grup të fokusit. Pjesëmarrëset gra e shohin veten si të përgatitura që nga lindja për detyrat e shtëpisë dhe e shohin ndihmën nga bashkëshorti, partneri, apo djemtë e tyre si favor nga ana e tyre. Për shembull, kujdesi për fëmijë konsiderohej të jetë detyrë e vështirë për burra, derisa ngritja e peshave të rënda nuk është adekuate për gra. Ndarja e barabartë e përgjegjësisë për punët e shtëpisë me partnerin ishte aq larg nga realiteti i grave sa që disa prej tyre përshkruanin partnerin e tillë si “burri i përkryer”. Diskutimet në grup të fokusit me burra arrinin përfundime të ngjashme, por ata e vinin fuqinë për këtë ndarje të punëve tek gratë, duke anashkaluar lehtësisht ndikimin e raporteve gjinore të fuqisë. Disa prej tyre theksonin që partnerët e tyre vetë kanë dëshirë t’i kryejnë këto detyra vetë, përkundër vullnetit të tyre për të ndihmuar. Kur pyeten për mendimet e tyre mbi ndarjen e detyrave, një numër më i madh i burrave se i grave mendojnë që burra e punëve të shtëpisë ndahet në mënyrë të barabartë mes tyre. Më se gjysma e burrave (55 për qind) e shohin si të barabartë, si dhe shumica dërmuese (91 për qind) deklarojnë të jenë të kënaqur me këtë organizim të detyrave në shtëpi. Përveç kësaj, rreth 92 për qind të burrave besojnë që partnerja e tyre është gjithashtu e kënaqur në këtë drejtim, dhe në të vërtetë, 89 për qind e grave pranojnë të jenë të kënaqura me këtë ndarje. Përkundër shkallës së vetë-deklaruar të kënaqshmërisë, rregullimi i tillë i detyrave të shtëpisë ka implikime praktike tek barazia gjinore ndërmjet burrave dhe grave.

## PËLQIMI I AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA ME PARTNEREN



Figura 22 - Raportimi i burrave mbi pëlqyeshmërinë e aktiviteteve të përbashkëta me partneren

Paragrafët vijues fokusohen tek **kujdesi prindëror dhe marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave si dhe fëmijëve të tyre**. Rreth 56 për qind e grave dhe 50 për qind e burrave deklarojnë të kenë fëmijë. Numri mesatar i fëmijëve edhe për burra edhe për gra ishte 3. Rreth shtatë për qind e grave deklaruan se nuk janë duke jetuar me të atin e fëmijëve. Nga këto raste, 28 për qind e grave thonë që babai nuk i ka parë asnjëherë fëmijët, derisa 59 për qind e tyre deklarojnë që babai ka vdekur. Të dhënat e raportuara nga respondentët burra tregojnë që 17 për qind e tyre deklarojnë të kenë fëmijë nën moshën 18-vjeçare që nuk jetojnë me ta. Nga këto raste, 63 për qind e tyre së paku nganjëherë sigurojnë përkrahje financiare për këta fëmijë.

Elemente po aq të rëndësishme në dinamikën e raporteve në shtëpi janë **komunikimi dhe kalimi i përbashkët i kohës** si çift. Kënaqshmëria me raportet me partnerin ishte habitshëm e lartë, por pati edhe dallime të vogla mes burrave dhe grave. Rreth 99 për qind e burrave, si dhe 89 për qind e grave do ta karakterizonin marrëdhënien e tyre si “tejet të mirë” apo “të mirë”. Figura 22 në të majtë tregon që aktiviteti që burrat e pëlqejnë më së shumti ta bëjnë bashkë me partneren apo bashkëshorten e tyre është kujdesi për fëmijët e tyre. Aktiviteti më së paku i pëlqyeshëm për ta është gatimi, që arrin notën mesatare prej 3.9 në shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është më së paku e pëlqyeshme ndërsa 5 është më e pëlqyeshmja.

Respondentët e anketës që nuk ishin beqarë gjithashtu janë pyetur për **aspektet më intime të marrëdhënies së tyre**. Rreth 64 për qind e burrave, si dhe 56 për qind e grave e përshkruajnë marrëdhënien e tyre seksuale me partnerin si “tejet të kënaqshme” apo “deri diku të kënaqshme”. Burrat gjithashtu kanë raporte më të larta të kënaqshmërisë sesa gratë në kuptimin e shpeshtësisë së marrëdhënieve seksuale me partneret e tyre. Duhet theksuar që numri i njerëzve që nuk i janë përgjigjur këtyre pyetjeve ishte mjaft i lartë, edhe pse kjo pjesë e pyetësorit ka qenë e vetë-administruar. Megjithatë, turpërimi nga diskutimi i marrëdhënieve seksuale nuk është i pazakonshëm në Kosovë, edhe për shkak të normave konservative sociale dhe kulturore.

**“Pushimi i atësisë nuk është diçka e zakonshme në shoqërinë tonë sepse burrat rrallëherë kujdesen për foshnjat. Për shembull, burri im nuk e ka mbajtur në duar djalin tonë deri ai i ka mbushur gjashtë muaj sepse ai ka thënë se nuk di si ta mban atë.**

Grua shqiptare e Kosovës –  
Pjesëmarrëse në diskutime në grup të fokusit

**Vendimi për të pasur fëmijë** është vendim që duhet të merret nga të dy partnerët dhe prania e tyre në çdo fazë është jetike për një raport të mirë dhe për rritjen e duhur të fëmijës<sup>41</sup>. Prej atyre që kanë pasur fëmijë, rreth 80 për qind kanë pohuar se të dytë, në mënyrë të barabartë, kanë dashur të kenë një fëmijë. Për më tepër, shumica e burrave (89 për qind) shoqëruan partneren e tyre gjatë vizitave para lindjes. Megjithatë, vetëm një në dhjetë burra, të cilët kanë pasur fëmijë, ishin të pranishëm në sallën e lindjes gjatë lindjes së fëmijës së tij të fundit. Kjo shifër mund të ndikohet nga rregullat e spitalit që nuk lejojnë gjithmonë praninë e baballarëve apo partnerëve në sallën e lindjes. Për shembull, 65 për qind e grave të cilat kanë lindur fëmijë kanë pohuar se partneri i tyre ka qenë në spital, por jo në sallën e lindjes. Për më tepër, në rreth 23 për qind të rasteve ku partneri nuk ka qenë i pranishëm në sallën e lindjes për lindjen e fëmijës, gratë e kanë arsyetuar këtë si një qëndrim që është i zakonshëm në bashkësinë e tyre. Për rastet kur babai mori pushim dhe u përfshi në fazën e hershme për rritjen e fëmijës, shumica dërrmuese e burrave (91 për qind) dhe shumë gra (55 për qind) u pajtuan se kjo periudhë e qëndrimit në shtëpi ka pasur ndikim pozitiv në raportin e tyre me fëmijën në fazat e mëvonshme.

Pjesëmarrësit në diskutimet në grup të fokusit u pajtuan me këto gjetje. Për qindja e ulët e grave të cilat kanë marrë **pushim të lehonisë** u shpjegua në bazë të shkallës së tyre të ulët të punësimit. Përveç kësaj, si burrat ashtu edhe gratë theksuan politikën e ashpra të sektorit privat, ku është e zakonshme që gratë të largohen nga vendi i punës menjëherë pasi që punëdhënësi të informohet për shtatzëninë e tyre. Pushimi i atësisë ku babai me të vërtetë kujdeset për fëmijën u konsiderua si diçka e pazakontë mes pjesëmarrësve të grupit të fokusit<sup>42</sup>. Ato më tej pohuan se kjo politikë ka të bëjë më shumë me gratë për shkak të besimit të tyre se është detyrë parësore e nënës që të kujdeset për të porsalindurin. Një grua serbe e Kosovës madje theksoi se ndihma e babait lypset kur asnjë anëtar tjetër i familjes nuk gjendet në shtëpi për t'i ndihmuar nënës. Prandaj, edhe një herë roli i babait konsiderohet më shumë si ndihmës për rritjen e fëmijës sesa si pjesë thelbësore në atë proces.

Ilustrimi 23 tregon se në përgjithësi, detyrat në lidhje me **kujdesin e fëmijëve** janë zakonisht ose të ndara mes të dy prindërve, ose merren përsipër nga nëna. Burrat të cilët u mësuan se si të kujdesen për vëllain a motrën gjatë fëmijërisë së tyre, kishin më shumë gjasa që të përfshiheshin në kujdesin ditor të fëmijëve të tyre. Ata po ashtu raportuan më shpesh se janë të përfshirë në dërgimin e fëmijëve të tyre në aktivitete të lira.

**“Ofrimi i së njëjtës kohë të pushimit për burrat dhe gratë do të kishte kuptim vetëm nëse pushimi i atësisë do të mund të bartej tek partneri.**

Grua serbe e Kosovës –  
Pjesëmarrëse në diskutime në grup të fokusit

<sup>41</sup> Një studim i UNFPA tregoi për praninë e përzgjedhjes së gjinisë para lindjes në bazë të paragjykitimit në Kosovë. Shih Christophe Z Guilmo (2016): Paragjykimi gjinor në Kosovë. UNFPA.

<sup>42</sup> Është me rëndësi të theksohet se legjislacioni në fuqi në Kosovë lejon vetëm dy ditë të pushimit të atësisë.

## NDARJA E DETYRAVE PËR KUJDESIN E FËMIJËVE




Figura 23 - Raportet e burrave për ndarjen e detyrave për kujdesin e fëmijës



Për më tepër, burrat raportuan se janë më shpesh të përfshirë në aktivitetet e lira me fëmijët, por rrallë apo asnjëherë nuk kanë përgatitur ushqim apo pastruar fëmijët e tyre. Burrat të cilët u anketuan kishin më shumë gjasa të luanin me fëmijët e tyre të vegjël (zero deri në katër vjeç) sesa me fëmijët e tyre më të mëdhenj (pesë deri në 14 vjeç). Sidoqoftë, ata përgatisin ushqim më shpesh për fëmijët e tyre të mëdhenj sesa për fëmijët e tyre të vegjël. Është kryesisht e pazakonshme që burrat të pastrojnë rrobat e fëmijëve të tyre; 64 për qind e tyre raportuan se ata asnjëherë apo rrallëherë e kanë bërë një gjë të tillë.

Nëse thellohemi në rolin e veçantë të babait për rritjen e fëmijëve të tyre, studimi tregon se pjesa thelbësore e rolit të babait është që të **sigurojë mbështetje financiare për familjen**. Në përgjithësi, 73 për qind e burrave ndiejnë se ata e kanë përgjegjësinë kryesore për mbajtjen e familjes. Megjithatë, shumica e burrave (53%) e pranojnë se kalojnë shumë pak kohë me fëmijët e tyre për shkak të punës së tyre dhe një përqindje tjetër e madhe e tyre (56%) e vështrojnë kryesisht si ndihmës rolin e tyre për kujdesin e fëmijëve. Kjo ndarje e prerë e detyrave për kujdesin e fëmijës mes burrave dhe grave i ka rrënjët jo vetëm në normat tradicionale, por edhe në realitetin ekonomik të familjeve në Kosovë. Përgjegjësia për mbajtjen e familjes bie kryesisht mbi burrat për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit dhe pagave më të larta që ata i marrin në krahasim me gratë. Pjesa më e madhe e barrës financiare po ashtu paraqet një formë tjetër të pabarazisë gjinore në shoqërinë tonë, siç është theksuar nga Kadri Gashi, përfaqësues i organizatës joqeveritare Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë, në intervistën me të. Burrat shpenzojnë pothuajse tërë energjinë dhe kohën e tyre duke punuar për të fituar para për familjet e tyre, gjë e cila rezultojnë në atë që ata të humbasin mundësinë për të kaluar kohë me fëmijët e tyre. Ajo çka sugjerohet në këtë rast është se normat e barazisë gjinore diktojnë edhe aspekte të veçanta të raportit mes baballarëve dhe fëmijëve të tyre. Megjithatë, analiza jonë e të dhënave nuk ka gjetur ndonjë korrelacion të rëndësishëm mes shkallës së përfshirjes së burrave si baballarë dhe normave të tyre gjinore siç janë matur nga shkalla e matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore. Po ashtu nuk ka pasur ndonjë dallim të madh mes grupeve të ndryshme të moshave, nivelit të arsimit dhe rolit të tyre si baballarë.

### 3.5. Shkalla e dhunës dhe akteve kriminale

Pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave janë ngushtë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Parandalimi i dhunës me bazë gjinore shpesh mbizotëron diskursin për pabarazinë gjinore, posaçërisht në shoqëritë më patriarkale. Kjo pjesë i kushtohet kryesisht dhunës së ushtruar nga burrat ndaj grave, por mbulon edhe format e tjera të praktikave abuzive, të dhunshme dhe kriminale. Basri Kastrati, drejtor i Zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, theksoi gjatë intervistës se vitin e kaluar u raportuan **1355 raste të dhunës në familje** dhe se kjo shifër paraqet një rritje prej rreth 100 rasteve në krahasim me vitin e kaluar. Disa akterë të cilët punojnë për së afërmi me rastet e tilla ishin të sigurt se numri i rasteve që janë raportuar ishte shumë më i vogël sesa numri i vetë incidenteve të dhunës në familje që kanë ndodhur në familje dhe ndaj grave. Megjithatë, shumë prej tyre thanë se kjo rritje në shkallën e raportimit bën të ditur për përmirësime në shkallën e ndërgjegjësimit si dhe potencialisht një shkallë më të madhe të besimit në institucionet përgjegjëse. Arsytet për **shkallën e ulët të raportimit** të incidenteve të tilla u diskutuan hollësisht në diskutimet në grup të fokusit dhe në intervistat e hollësishme. Faktorët më të rëndësishëm për mos kërkimin e ndihmës ishin frika nga braktisja dhe stigmatizimi, besimi i ulët në institucione, pasiguria ekonomike e grave dhe perspektiva e dobët për të ardhmen e grave të cilat ishin viktimat e dhunës dhe fëmijët e tyre. Biljana Rexhiq, gjyqtare në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, po ashtu theksoi mendësinë si një pengesë të madhe për trajtimin e këtyre çështjeve: “Deri në vitin 2001, kur UNMIK-u miratoi rregulloren e parë për mbrojtje nga dhuna në familje, kjo dukuri është konsideruar si çështje kryekëput private dhe absolutisht nuk ka pasur raste që janë raportuar. Diskutimi për dhunën në familje ka qenë temë tabu.”

Shumica e hisedarëve të cilët janë intervistuar vërejtën elemente të tjera që i bëjnë gratë, të cilat janë **të varura nga burri i tyre në kuptimin ekonomik dhe social**, të mendojnë dy herë para se të raportojnë. Përveç paragjyqimit dhe vështirësive me të cilat përballen në një shoqëri të vogël dhe konservatore, gratë duhet gjithashtu të përballen me mungesën e strehimoreve dhe ndihmës financiare, mundësi të pakta në tregun e punës dhe ndihmën e rrallë për rritjen e fëmijëve. Çka është edhe më keq, procedurat e gjata gjyqësore si dhe zbatimi i dobët i vendimeve të gjykatave e bëjnë raportimin e dhunës tepër të kushtueshëm, në kuptimin ekonomik dhe emocional, për gratë. Një mendim tjetër i përhapur ishte se dënimet më të rënda që zbatohen ashtu siç duhen do t'i shtynin “burrat të mendojnë dy herë para se ta ngritin dorën e tyre ndaj grave”. Faktori i frikës, pra, shihet si metodë e zbrapsjes tek sjellja e dhunshme. Megjithatë, disa hisedarë të tjerë deklaruan se institucionet, organizatat joqeveritare dhe shoqëria në përgjithësi nuk po i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme vetë abuzuesve. Nuk ka informata të mjaftueshme për faktorët që i shtynë këta njerëz drejt sjelljes së dhunshme dhe, rrjedhimisht, nuk ekzistojnë programe parandalimi apo rehabilitimi.

Prandaj gjetjet si në vijim mëtojnë të hedhin dritë mbi rrënjët e dhunës ndaj grave dhe pasojave të tyre për barazinë gjinore. Në pjesën për përvojat e fëmijërisë, u cek se 20 për qind e burrave kanë qenë dëshmitarë të rrahjes së nënës së tyre nga babai i tyre apo partneri i saj, së paku një herë gjatë kohës sa janë rritur. Analiza e mëtejme tregon se burrat të cilët jetojnë në zonat rurale kanë pasur më shumë gjasa që të jenë dëshmitarë të kësaj forme të dhunës gjatë rritjes së tyre, sesa ata të cilët jetojnë në vendbanime urbane. Përveç kësaj, normat gjinore duket se janë në korrelacion me ekspozimin ndaj dhunës ndaj grave në shtëpi. Burrat të cilët kanë norma më të ulëta të barazisë gjinore kishin pasur më shumë gjasa të kenë parë nënën të rrihet nga babai i tyre apo partneri i saj, së paku një herë gjatë kohës sa janë rritur.

“**Pritjet që caktohen për burrat jo vetëm që rrënjosin në ata këndvështrime të ngurta të burrërisë, por edhe i bën ata viktimë kur nuk mund të përmbushin pritjet e tilla, duke i shkaktuar shpesh ndjenja të besimit të ulët apo depresionit. Prandaj, këto norma që rrethojnë djemtë gjersa rriten shpesh i shtynë ata drejt sjelljes së dhunshme dhe njëkohësisht i privojnë ata nga të mirat shoqërore.**

Besnik Leka  
Koordinator projekti  
CARE International

Kur analizuam **shkallën e raportimit vetanak për kryerjen e dhunës ndaj grave**, ne zbuluam se 12 për qind e kanë goditur së paku një herë me shuplakë, grusht apo kanë gjuajtur diçka në drejtim të partneres së tyre. Përveç kësaj, ilustrimi 24 tregon se katër për qind e burrave kanë ushtruar madje edhe forma më të rënda të dhunës si goditja me shkelma, zvarritja, rrahja, asfiksioni apo djegia e partneres, ndërsa pesë për qind e kanë pranuar se kanë kërcënuar se do të përdorin ose në të vërtetë kanë përdorur armë, thikë apo ndonjë armë tjetër ndaj partneres së tyre. Këto përqindje të raportuara të incidenteve të dhunshme u mbështetën edhe nga rastet e akteve të dhunshme të kryera ndaj grave, e të cilat u raportuan nga vetë gratë siç edhe paraqitën në figurën 25.

Megjithatë, kishte shumë pak vërtetime për të na lejuar që të përcaktojmë një raport të rëndësishëm statistikor mes pikëve në shkallën e matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore dhe shkallës së raportimit vetanak të incidenteve. Të dhënat po ashtu tregojnë se sa më i vjetër në moshë dhe sa më pak i arsimuar të ketë qenë i anketuari, ka pasur më shumë gjasa që ai të ketë goditur partnerin e tij së paku një herë.

### PËRQINDJA E BURRAVE TË CILËT KANË USHTRUAR DHUNË NDAJ PARTNERIT TË TYRE




Figura 24 – Përqindja e burrave të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj partneres së tyre

### PËRQINDJA E GRAVE TË CILAT KANË PËRJETUAR DHUNË NGA PARTNERI I TYRE





Figura 25 – Përqindja e grave të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri i tyre

Diskutimi i rasteve të **përdhunimit** është shpesh temë tabu në shoqëritë tradicionale. Për ironi, edhe shoqëritë tradicionale si dhe ato liberale shpesh e përhapin kulturën e përdhunimit në forma të shumëfishta. Kultura e përdhunimit mund të kuptohet si norma të një shoqërie që lejojnë ose madje promovojnë qëndrime shoqërore që normalizojnë, apo çka është edhe më keq, ua ulin rëndësinë sulmit dhe abuzimit seksual. Kjo shprehje është përdorur fillimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitet 1970. Që nga ajo kohë, ajo është përdorur dhe argumentuar në literaturën feministe<sup>43</sup>.



<sup>43</sup> Buchwald, E., Fletcher, P. R., & Roth, M. (bot.). (2005). Transformimi i kulturës së përdhunimit (*Transforming a Rape Culture*). Milkweed Editions.

Burrat si dhe gratë u pyetën për mendimin e tyre në lidhje me deklaratat gjegjëse, me qëllim që të kuptojmë më mirë përhapjen e kulturës së përdhunimit. Ilustrimi 26 paraqet dhe krahason perceptimet e të dyja gjinive mbi përdhunimin. Burrat kanë pak më shumë gjasa që të pajtohen me normat e kulturës së përdhunimit. Për shembull, 30 për qind e burrave do të pajtoheshin se nuk mund të konsiderohet si rast përdhunimi nëse gruaja nuk kundërshton fizikisht. Çka është interesante, 25 për qind e grave gjithashtu pajtohen me këtë deklaratë. Edhe fajësimi i viktimës nuk është diçka e panjohur. Rreth 20 për qind e burrave dhe 23 për qind e grave konsiderojnë se në çfarëdo rasti të përdhunimit, njëri duhet të parashtrojë pyetjen nëse viktima është imorale apo gëzon një reputacion të keq.

### MENDIMET E BURRAVE DHE GRAVE PËR PËRDHUNIMIN




Figura 26 - Mendimet e burrave dhe grave për përdhunimin

“Perceptimi i përdhunimi më shumë si shkelje e nderit të familjes, sesa dhunim i integritetit seksual të grave është ende mbizotërues në shoqërinë tonë, megjithëse është më i zakonshëm në zonat rurale sesa në ato urbane.

Veprorë Shehu  
Drejtore Ekzekutive  
Medica Kosova, Gjakovë

Opinionet mbizotëruese për përdhunimin në mënyrë të konsiderueshme ndikohen nga normat gjinore në shoqëri. Ekziston një korrelacion i lartë statistikor mes shkallës së matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore dhe shkallës së pajtimit në fjalitë e mëparshme që lidhen me përdhunimet. 46 për qind e burrave me vlerësim të ulët në shkallën e matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore mendojnë se në një rast përdhunimi duhet hetuar reputacioni i viktimës, kurse 15 për qind e burrave me vlerësim të lartë në shkallën e matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore e ndajnë po të njëjtin mendim. Disa burra dhe gra në diskutimet në grup të fokusit shfaqën qëndrime që janë në përputhje me kulturën e përdhunimit siç u përkufizua më sipër. Për shembull, ata thanë se gratë duhet t'i kushtojnë vëmendje mënyrës se si vishen, veprojnë dhe me kë shoqërohen nëse nuk duan të provokojnë burrat apo ta vendosin veten në situata të rrezikshme. Ndonëse pjesëmarrës të caktuar në të vërtetë nuk u pajtuan fare me këto deklaratat, diskutimi në fjalë sugjeroi se viktimat e përdhunimit mund të kenë shmangur incidentin apo se shpesh ato fajësuan veten e tyre.

Përtej të dhënave për perceptimin, rezultatet e anketës po ashtu tregojnë se një në 20 burra pranuan të kenë pasur **marrëdhënie seksuale pa pëlqim** me një grua së paku një herë gjatë jetës së tyre. Normat shoqërore në shoqëritë konservatore shpesh i japin të drejtën burrave të kenë marrëdhënie seksuale, edhe kur gruaja apo e dashura e tyre nuk dëshiron një gjë të tillë. Është me rëndësi të theksohet se gjatë kohës së Jugosllavisë dhuna seksuale bashkëshortore nuk ishte e penalizuar. Kjo çështje u ngrit edhe gjatë grupit të fokusit me gratë serbe të Kosovës, pra çështja e përdhunimit brenda një marrëdhënie apo martese. Dy pjesëmarrës u shprehën sesi ky lloj i sjelljes zakonisht as që mendohet si përdhunim në shoqëri sepse burrat i konsiderojnë marrëdhëniet seksuale me partnerin e tyre si një e drejtë e tyre e pandashme dhe jo si diçka për të cilën gjë ju duhet pëlqimi. Figura 27 tregon se një në 25 burra e kanë detyruar të dashurën apo gruan e tyre të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta.

### PËRHAPJA E PËRDHUNIMIT SIÇ RAPORTOHET NGA BURRAT




Figura 27 - Përhapja e përdhunimit siç raportohet nga burrat





### 3.6. Praktikrat shëndetësore

Pabarazia gjinore prekë sferat e ndryshme të jetës madje edhe ato që në dukje janë të palidhura me njëra-tjetrën, si zakonet e shëndetit. Për shembull, normat gjinore mund të kufizojnë qasjen në kujdesin shëndetësor apo të bëjnë që shoqëria të konsiderojë si të papranueshme shprehi të caktuara shëndetësore e të cilat do të mund të shpëtonin apo përmirësonin jetën e shumë burrave dhe grave. Kultura të caktuara mund të presin nga burrat që të konsumojnë pije alkoolike në sasi të mëdha apo që të shmangin kujdesin shëndetësor<sup>44</sup>. Në mënyrë të ngjashme, nga gratë mund të pritet që të mos kenë trajtim të barabartë përkitazi me planifikimin e familjes apo që të shmangin aktivitete të caktuara fizike<sup>45</sup>.

Paragrafi në vijim paraqet **shprehi aktuale shëndetësore të burrave dhe grave** në Kosovë, si dhe mënyrat sesi ato ndërlidhen me normat gjinore që ata i mbështesin. Shumica e burrave (63 për qind) dhe grave (67 për qind) kanë kërkuar shërbime shëndetësore në një klinikë, spital apo shërues popullor gjatë vitit të kaluar. Një gjetje shqetësuese është se 11 për qind e grave dhe 16 për qind e burrave asnjëherë nuk e kanë vizituar mjekun. Arsyja kryesore për shërbime shëndetësore ka qenë kryerja e kontrollit mjekësor. Vizitat mjekësore në lidhje me shëndetin reprodaktiv ishin tepër të rralla ndër të dyja gjinitë. Shkalla e raportimit vetanak për testin HIV ishte po ashtu relativisht e ulët; 3 për qind e grave dhe 4 për qind e burrave e pranuan se kanë bërë HIV testin së paku një herë.

Rreth dy për qind e burrave kanë pasur një partnere e cila ka përjetuar një **abort të detyruar** dhe 32 për qind e tyre kanë qenë pjesë e këtij vendimi. Gjetjet për gratë tregojnë se pesë për qind e tyre kanë pohuar se kanë pasur një abort të detyruar dhe se në 43 për qind të këtyre rasteve partneri i tyre e ka qenë pjesë e këtij vendimi. Partneri i tyre e ka paguar procedurën në 57 për qind të rasteve, pra kur gratë kanë kryer abort të detyruar. Ndërsa një përqindje e vogël e burrave (31%), partneret e të cilëve kanë pasur një abort të detyruar, pohuan se e kanë paguar procedurën, shumica e burrave (78%) e kanë shoqëruar partneren e tyre për abort.

**Shëndeti mendor**, shpeshherë i shpërfillur në mjedisin burrëror, është shumë i ndikuar nga normat gjinore. Ai është edhe ngushtë i lidhur me sjelljen abuzive dhe praktikrat diskriminuese në bazë të gjinisë. Përveç kësaj, hulumtimet kanë treguar për një korrelacion të qëndrueshëm mes gjinisë dhe përhapjes së çrregullimeve mendore të tilla si depresioni, ankthi, etj. Për shembull, studimet kanë treguar se depresioni i rëndë është dy herë më i zakonshëm për gratë sesa për burrat<sup>46</sup>. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka tërhequr vëmendjen për mosvënien e theksit në rolin dëmtues që e ka pabarazia gjinore në shëndetin mendor. Për shembull, normat gjinore i diktojnë raportet e pushtetit mes burrave dhe grave dhe rrjedhimisht ato gjithashtu prekin faktorët që kanë të bëjnë me shëndetin mendor, si pozita shoqërore, trajtimi në shoqëri si dhe përgjithësisht ekspozimi ndaj rreziqeve të caktuar të shëndetit mendor<sup>47</sup>.

<sup>44</sup>Sobal, J. (2005). Burrat, mishi dhe martesat: Modelet e burrërisë, *Food and Foodways*, 13(1-2), 135-158. and Noone, J. H., & Stephens, C. (2008). Burrat, identiteti burrëror dhe shfrytëzimi i kujdesit shëndetësor. *Sociology of Health & Illness*, 30(5), 711-725.

<sup>45</sup> Spencer, R. A., Rehman, L., & Kirk, S. F. (2015). Kuptimi i normave gjinore, të ushqyerit dhe aktivitetit fizik tek vajzat adoleshente: një rishikim themeltar. *International Journal of Behavioral Nutrition and Physical Activity*, 12(1), 6. ; Li, J. (2004). Pabarazia gjinore, planifikimi i familjes dhe kujdesi amënor dhe për fëmijën në një qark rural të Kinës. *Social Science & Medicine*, 59(4), 695-708.

<sup>46</sup> Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (2015). *Trendët dhe statistikat për gratë e botës për vitin 2015*; Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2007). *Pabarazitë gjinore në shëndetin mendor*. Departamenti i Shëndetit Mendor dhe Vartësisë nga Substancat

<sup>47</sup> Po aty.

Duke qenë se ky studim përqendrohet në pikëpamjet e burrave, gjetjet e paraqitura këtu janë më të shtjelluara për burrat sesa për gratë. Burrat u pyetën për atë se sa pajtohen me disa deklaratat përkitazi me **vetëbesimin e tyre**. Për shembull, ilustrimi 28 tregon se përkitazi me dukjen fizike, shumica dërrmuese e burrave (92 për qind) janë relativisht të kënaqur me trupin e tyre. Megjithatë, një pjesë më vogël e tyre (83 për qind) konsiderojnë se ata kanë shumë arsye për të qenë krenar. Në aspektin negativ, 13 për qind e burrave ndiejnë se jeta e tyre nuk i hyn në dobi askujt dhe madje një pjesë më e madhe (24 për qind) ndonjëherë ndihen inferior në shoqërinë e miqve.

### SHKALLA E VETËBESIMIT E BURRAVE




Figura 28 - Deklaratat e burrave për vetëbesimin

Paragrafi në vijim paraqet prevalencën e **kushteve dhe simptomave të ndërlidhura të shëndetit mendor** tek burrat. Gjatë muajit të kaluar, 31 për qind e burrave kanë përjetuar stres së paku ndonjëherë apo edhe më shpesh. 14 për qind prej tyre kanë përjetuar depresion ndonjëherë apo edhe më shpesh, dhe ajo çka është më e keqja, pesë për qind e kanë pranuar se kanë pasur herë pas herë ndjenja vetëvrasëse gjatë muajit të kaluar. Analiza e mëtejme tregon se statusi i punësimit ishte i ndërlidhur me ndjenjat e stresit dhe depresionit. Zakonisht ishin pensionistët dhe ata të cilët janë të punësuar në mënyrë joformale, të cilët kishin më shumë gjasa të ndiejnë stres apo që kanë përjetuar depresion së paku një herë gjatë muajit të kaluar. Rreth 49 për qind e pensionistëve janë ndier në depresion në muajin e kaluar kundrejt mesatares prej 28 për qind të të gjithë burrave të cilët kanë përjetuar të njëjtën gjë. Sipas pjesëmarrësve në grupe të fokusit, një nga arsyet për nivele të larta të stresit ishin tronditjet dhe ndryshimet në stilin e jetës nga socializmi në konflikt dhe më pas në gjendjen aktuale të paqëndrueshme ekonomike.






Figura 29 - Përhapja e përdorimit të alkoolit dhe drogave tek burrat

Grupi i burrave, të cilët i takonin normave më të ulëta të barazisë gjinore siç matet nga shkalla e matjes së qëndrimeve të burrave për barazinë gjinore, kanë pasur më shumë gjasa të kenë përjetuar stres, depresion dhe mendime vetëvrasëse gjatë muajit të kaluar. Përveç kësaj, ne gjetëm edhe një korrelacion pozitiv mes stresit dhe shprehive të pirjes si dhe stresit dhe sjelljes së dhunshme. Një element tjetër i rëndësishëm i zakoneve shëndetësore është përhapja e sjelljes së rrezikshme si përdorimi i substancave. Ilustrimi 29 tregon se 14 për qind e burrave konsumojnë pije alkoolike dy herë në muaj apo edhe më shpesh. Nga ky grup, 28 për qind prej tyre kanë konsumuar alkool për qejf (më shumë se pesë pije në një rast të vetëm) së paku një herë në javë.

Përhapja e përdorimit të drogës ishte shumë më e ulët sesa ajo e konsumimit të alkoolit, siç paraqitet në ilustrimin 29. Hulumtimet në shkallë botërore kanë treguar se dallimet gjinore janë gjithashtu të pranishme edhe në mënyrat e **kërkimit të ndihmës për çështje të shëndetit mendor**, meqenëse është më e zakonshme për gratë sesa për burrat që të kërkojnë ndihmë mjekësore dhe zbulojnë problemet e tyre për shëndetin mendor tek mjeku i tyre<sup>48</sup>. Në përgjithësi burrat ngurrojnë që të diskutojnë dhe të pranojnë simptomat e depresionit, gjë e cila përforcon stigmatizimin social dhe kufizon kërkimin e ndihmës përgjatë mënyrave stereotipike<sup>49</sup>. Kur shqyrtojmë trendët e kërkimit të ndihmës për çështjet emocionale, të dhënat për Kosovën nuk sigurojnë dallime të mëdha mes të dyja gjinive. Rreth 54 për qind e grave kërkojnë ndihmë nga të tjerët kur ndihen të pikëlluara, të zhgënjyera apo të frustruara, për dallim prej 48 për qind të burrave. Një analizë e mëtejme e të dhënave tregon se burrat mund ta lidhin kërkimin e ndihmës me mungesën e burrërisë. Ata të cilët e kanë përqafuar barazinë gjinore kishin më shumë gjasa që të kërkonin ndihmë për dallim prej atyre të cilët nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Burrat dhe gratë zakonisht kërkojnë ndihmë nga partneri apo i afërmi i tyre. Vetëm dy për qind e burrave dhe grave kanë kërkuar ndihmë nga mjeku në lidhje me këto çështje. Diskutimet në grup të fokusit po ashtu konfirmuan sugjerimet se shëndeti mendor është temë tabu në shoqëri, për shkak të mendësisë tradicionale dhe paragjyqimeve. Sipas pjesëmarrësve burra dhe gra, vizita tek psikologu shpesh ka qenë e barabartë me të qenit i çmendur. Sidoqoftë, të gjithë e pranuan rëndësinë e jashtëzakonshme për atë që burrat dhe gratë të trajtojnë dhe kërkojnë ndihmë për problemet e shëndetit mendor.

<sup>48</sup> Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (2015). *Trendët dhe statistikat për gratë e botës për vitin 2015*.

<sup>49</sup> Po aty.

### 3.7. Politikat dhe ligjet mbi barazinë gjinore

Kjo pjesë i kushtohet posaçërisht nivelit të ndërgjegjësimit mes banorëve të Kosovës për politikat dhe ligjet për barazinë gjinore, si dhe mendimet e tyre për to. Duke qenë se strategjitë dhe ligjet shpeshherë miratohen për shkak të ndikimit të jashtëm, është me rëndësi që të kuptohet se sa zbatohen ato dhe si i transmetohen dhe si pranohen nga popullsia. Është gjithashtu me rëndësi që të kuptohet kapaciteti i ligjeve dhe politikave të tilla për të pasur ndikim të vërtetë për promovimin dhe përmirësimin e barazisë gjinore në shoqëri. Të gjithë hisedarët të cilët u intervistuan ishin të një mendimi se korniza ligjore për barazinë gjinore në Kosovë është krijuar dhe formuluar mirë.

Neni 7 i Kushtetutës siguron barazinë gjinore si “vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë”. Për më tepër, neni 24 i Kushtetutës përcakton se janë të ndaluara të gjitha format e diskriminimit, përfshirë diskriminimin në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual. Ndalimi i të gjitha formave të diskriminimit dhe vlerat themelore të barazisë gjinore janë zgjeruar me anë të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligjit për barazinë gjinore (të dy të miratuar në vitin 2015).

Ndonëse Ligji për barazinë gjinore përcakton se nuk duhet të ketë dallim apo diskriminim në bazë të gjinisë në marrëdhëniet e punës, Ligji për punë nuk i përcakton saktësisht të njëjtat dispozita për **pushim të lehonisë dhe pushim të atësisë**. Në të vërtetë, nuk ekziston ndonjë ‘pushim i atësisë’ që është i përcaktuar veçanërisht e që i jep babait të drejtat e njëjta apo të ngjashme si nënës. Megjithatë, ekzistojnë dispozita që mund të quhen formë e kufizuar e pushimit të atësisë e që përbëhen nga dy ditë pune me pagesë dhe deri në 14 ditë pune pa pagesë. Pushimi i lehonisë përcakton se gratë kanë të drejtë në 12 muaj të pushimit të lehonisë, prej së cilave 6 muajt e parë do të kompensoheshin pjesërisht.

Rezultatet e anketës tregojnë se vetëm 13, përkatësisht 70 për qind e burrave ishin në dijeni për ekzistimin e ligjeve për pushim të atësisë dhe pushim të lehonisë. Prej këtyre burrave, rreth 76 për qind e dinin se pushimi i atësisë zgjat më pak se një javë dhe 40 për qind ishin në dijeni se pushimi i lehonisë zgjat më shumë se 6 muaj. Kur u pyetën për mendimin e tyre për atë nëse duhet të ekzistojnë ligje që garantojnë pushim për prindërit e rinj, 65 për qind e burrave u pajtuan se pushimi i atësisë duhet të garantohet, kundrejt 84 për qind prej tyre të cilët menduan të njëjtën gjë për pushimin e lehonisë. Njohuria e grave në Kosovë për këto ligje është e krahasueshme me atë të burrave. Për shembull, 12 dhe 67 për qind e tyre ishin në dijeni për ekzistimin e ligjit për pushimin e atësisë, përkatësisht pushimin e lehonisë. Përveç kësaj, 80 për qind e grave të cilat ishin në dijeni për pushimin e atësisë gjithashtu e dinin se ai zgjat më pak se një javë, kurse 42 për qind e dinin se pushimi i lehonisë zgjat më shumë se 6 muaj. Rreth 63 për qind e grave konsiderojnë se pushimi i atësisë duhet të garantohet me anë të ligjit dhe 71 për qind mendojnë të njëjtën gjë për pushimin e lehonisë.

“*Zhvillimet ligjore dhe të politikave ndërmerren aty për aty, më tepër për të përmbushur kërkesat e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare sesa që mbështeten në nevojat që konsiderohen jetike për zhvillimin e shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi.*”

Hilmi Jashari  
Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës

### VETËDIJA PËR LIGJET E PUSHIMIT TË LINDJES




Figura 30 - Ndërgjegjësimi lidhur me ligjet për atësinë dhe amësinë tek gratë dhe burrat

**Barazia ndërmjet bashkëshortëve** ceket si parim rregullativ për raportet familjare në ligjin e familjes në Kosovë. Nëse martesë lidhet me anë të frikës, dhunës ose kërcënimit serioz, ligji përcakton se ajo do të anulohet. Ligji për familjen përfshin masa për të mbrojtur nënën dhe fëmijët nga efektet e shkurorëzimit dhe atyre u sigurohet përkujdesje edhe pas shkurorëzimit. Shkurorëzimi mund të iniciohet nga njëra palë, apo përmes marrëveshjes reciproke.

Respondentët janë pyetur për opinionin e tyre lidhur me **dispozitat ligjore të cilat rregullojnë martesën, shkurorëzimin dhe kujdestarinë e fëmijëve**. Burrat përgjithësisht besojnë se dispozita ligjore mbi shkurorëzimin ose kujdestarinë e fëmijës i trajtojnë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë. Gratë kanë shkallë më të lartë të përgjigjeve “nuk e di”, që tregon një nivel më ulët të vetëdijesimit mbi këto ligje. Rreth 34 për qind të burrave besojnë se kujdestaria e përbashkët nuk është e rëndomtë në shoqërinë e tyre. Për më tepër, 22 për qind e burrave besojnë se ligjet për përcaktimin e kujdestarisë së fëmijëve pas shkurorëzimit favorizojnë gratë më shumë se burrat. Shumica e grave (62 për qind) dhe 48 për qind e burrave nuk ishin në dijeni për ligjet mbi përcaktimin e atësisë së fëmijës. Ata që ishin në dijeni për këto ligje përgjithësisht besonin se ato ishin të drejta si për burrat ashtu dhe për gratë.

## MENDIMET PËR LIGJIN E DIVORCIT





Figura 31 - Opinione lidhur me ligjet për shkurrëzimin tek gratë dhe burrat

Çështja e **dhunës në familje** është e rregulluar përgjithësisht me ligj, sipas së cilit të gjitha format e saj janë të ndaluara. Për shumë vepra si skllavëria, puna e detyruar, ngacmimi, përdhunimi, sulmet seksuale, degradimi i integritetit seksual, abuzimi seksual i personave me aftësi të kufizuara dhe abuzimi seksual i të miturve, dënimi minimal me burgim rritet me një ose dy vite nëse vepra kryhet brenda marrëdhënies familjare. Vitin e kaluar u miratua një strategji specifike për dhunën në familje - Strategjia kundër Dhunës në Familje 2016-2020.

Gjetjet e radhës përqendrohen në vetëdijesimin dhe opinionet e burrave dhe grave lidhur me **dispozitat ligjore mbi dhunën në familje** të cilat janë përmbledhur shkurtimisht më sipër. Rreth 68 për qind e burrave dhe 56 për qind e grave ishin të vetëdijshëm se sistemi i drejtësisë në Kosovë përmban ligje për këtë çështje. Në njërën anë, respondentët që ishin në dijeni për këto ligje përgjithësisht mendojnë se ato e bëjnë shumë të lehtë që një grua të ngrisë akuzë për dhunë ndaj një burri. Nga ana tjetër, figura 32 tregon se burrat dhe gratë me shumë gjasë pajtohen me mungesën e mbrojtjes së mjaftueshme që këto ligje ofrojnë për viktimat e abuzimit. Për më tepër, 58 për qind e grave dhe 48 për qind e burrave besonin se ligjet e tilla ekspozojnë gruan në stigmatizim dhe dhimbje më të madhe. Kjo u konfirmua edhe më tej në diskutimet në grupe të fokusit si dhe në intervistat e hollësishme me palët e interesit.



## MENDIMET PËR LIGJET KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE





Figura 32 - Opinonet lidhur me ligjet mbi dhunën ndaj grave

Ligji për Barazi Gjinore ndalon çdo lloj **diskriminimi në baza gjinore**. Ligji aplikon masa të veçanta, siç janë kuotat për të siguruar barazi, si dhe përcakton poste publike për ekspertë të barazisë gjinore në institucionet publike. Ky ligj gjithashtu krijon mekanizma institucionalë për barazinë gjinore. Në këtë ligj ka dispozita që sigurojnë mbrojtje dhe trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punës, fushën e arsimit, si dhe parashihen dispozita ndëshkuese për shkelje të neneve.

Përderisa, sipas të dhënave, burrat përgjithësisht nuk besojnë se pabarazia gjinore është shqetësim i madh për Kosovën, shumica prej tyre ende mbështesin politikat e diskriminimit pozitiv për gratë. Përgjithësisht, ata ishin në favor të **sistemit të kuotave** për gratë në politikë dhe pozita ekzekutive. Ata gjithashtu ishin më të prirë që të mbështesin paga të barabarta për burra dhe gra në të njëjtën pozitë pune. Shkalla më e lartë e matjes së qëndrimeve të burrave ndaj barazisë gjinore gjithashtu lidhet pozitivisht me mbështetjen e sistemeve të kuotave për gratë në institucione publike, si dhe me ligjet që nxisin paga të barabarta. Një gjetje e rëndësishme nga intervistat e hollësishme me palët e interesit ishte ndikimi pozitiv që ka pasur sistemi aktual i kuotave në përmirësimin e barazisë gjinore në Kosovë. Përderisa shumë palë të interesit nuk e shihnin këtë politikë si zgjidhje afatgjate për pabarazinë gjinore, ata megjithatë e theksuan rëndësinë e saj për fillimin e kësaj beteje. Siç është theksuar në intervistën me Edi Gusinë, drejtorë e Agjencisë për Barazi Gjinore, masa afirmative i mundësoi gratë që të hyjnë në politikë dhe pasi iu dha mundësia, numri i votave të fituara ishte dukshëm më i lartë në zgjedhjet e vitit 2017 krahasuar me ato të mëparshme. Kjo u arrit edhe përkundër pabarazisë me të cilën ato ballafaqohen brenda partive të tyre politike. Në një intervistë me Vlora Nushin dhe Linda Sanajën nga UN Women, u theksua se buxheti zgjedhor ndahet ndryshe për gratë dhe burrat brenda partisë, gjë që i vendos gratë menjëherë në pozitë të pafavorshme. Akterë të tjerë madje kërkojnë kuotë më të madhe (50/50) në të gjitha institucionet publike. Gjithashtu, disa akterë ngritën edhe mungesën e grave në pozita ekzekutive në shumë institucione vendimtare publike dhe kompani private.


### SISTEMI I KUOTAVE PËR GRATË NË POZITA EKZEKUTIVE

■ Për ■ Kundër ■ Nuk e di



### SISTEMI I KUOTAVE PËR GRATË NË QEVERI, PARLAMENT, MINISTRI APO KOMUNA

■ Për ■ Kundër ■ Nuk e di



### LIGJET QË PROMOVOJNË PAGA TË BARABARTA PËR BURRAT DHE GRATË NË TË NJËJTAT POZITA

■ Për ■ Kundër ■ Nuk e di




Figura 33 - Mbështetja e burrave për politikat dhe ligjet për barazinë gjinore

Së fundi, një pikë tjetër e shtjelluar në kuadër të këtij hulumtimi lidhet me martesën e të njëjtit seks. Aktualisht, sipas Ligjit të Familjes në Kosovë, Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme<sup>50</sup>. Megjithatë, neni 24 i Kushtetutës ndalon diskriminimin në baza të orientimit seksual. Se ligji është i paqëndrueshëm në këtë fushë, në një masë mund të jetë si pasojë e numrit të ulët të njerëzve në Kosovë që janë në dijeni të ligjeve që i mbrojnë ata nga diskriminimi. Ky hulumtim tregoi se rreth 24 për qind e grave dhe 26 për qind e burrave ishin në dijeni për ligjet që mbrojnë njerëzit nga diskriminimi - duke përfshirë ata që tërhiqen nga gjinia e njëjtë. Burrat ishin më me gjasë të jenë kundër ligjeve të tilla se sa gratë. Kjo vlen për ligjet që garantojnë bashkimin civil apo martesën midis çifteve të seksit të njëjtë, ose atyre gejë apo lezbikë. Natyrisht, burrat që i përkisnin shkallës së lartë të matjes së qëndrimeve të burrave ndaj barazisë gjinore ishin më me gjasë të mbështetnin ligje ose politika kundër diskriminimit të njerëzve që tërhiqen nga gjinia e njëjtë. Gjersa nuk ekziston një model i qartë i moshës për mbështetjen e këtyre politikave, një rezultat del më në pah: 80 për qind e burrave të moshës 50-60 vjeçe janë kundër këtyre ligjeve.

<sup>50</sup> Neni 14 i Ligjit për familjen: "(1) Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. (2) Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj."



## 4. Konkluzë

Qëllimi për kryerjen e këtij studimi ishte që të sigurohet një perspektivë të re mbi barazinë gjinore në Kosovë. Ky hulumtim, i pari i llojit të tij në Kosovë, kishte në fokus burrat, përvojat dhe perceptimet e tyre, dhe si i formësojnë ata faktorët aktualë që ndikojnë në pabarazinë gjinore sot. Përmes gjurmimit të përvojave të fëmijërisë, dinamikave të marrëdhënieve aktuale, qëndrimeve ndaj gjinisë, dhunës dhe shëndetit, hulumtimi paraqet një pasqyrë të harmonizuar të barazisë gjinore nga perspektiva e burrave në Kosovë. Shumica e burrave në Kosovë i përkasin grupit të barazisë mesatare të normave gjinore siç përshkruhet në shkallën e matjes së qëndrimeve të burrave ndaj barazisë gjinore. Megjithatë, kjo gjetje bazohet vetëm në masën në të cilën ata pajtohen me deklaratat mbi barazinë gjinore. Nëse marrim parasysh veprimet dhe qëndrimet e tyre aktuale, situata ndryshon ndjeshëm. Elementet siç janë aranzhimi aktual i ekonomive familjare dhe situata e grave në përgjithësi ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për nivelin e rëndë të barazisë gjinore në Kosovë.

Burrat në Kosovë janë rritur në familje patriarkale ku gratë janë të mbyllura brenda kuzhinës dhe me detyra të kujdesit të fëmijëve, ndërsa burrat ishin përgjegjës për marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe sigurimin e të ardhurave për familjet e tyre. Gjersa këto karakteristika ishin më pak të dukshme në familjet me nivel të lartë arsimor, megjithatë ishte e pazakontë që gratë të kenë fjalën e fundit në vendimet e rëndësishme ose të konsideroheshin si të barabarta me burra. Shoqëria ka qenë e organizuar ashtu që role të caktuara ishin rreptësisht të burra dhe të tjera për gra. Gjatë rritjes, dhuna normalizohej si pjesë e metodës disiplinore. Nuk ishte e pazakontë që burrat në Kosovë të kenë përjetuar dhunë në familjen e tyre qoftë ndaj vetes, nënës së tyre apo ndaj familjareve tjera. Kjo metodë e zgjidhjes së problemeve përdorej gjithashtu në shkolla dhe mes fqinjëve, ndërmjet vetë burrave ose personave të tjerë autoritarë.

Këto përvoja fëmijërore padyshim që kishin ndikim në pikëpamjet dhe praktikat e burrave dhe grave sot. Përderisa gjërat kanë filluar të lëvizin ngadalë në drejtimin e duhur, marrëdhëniet e pushtetit në shtëpi për burrat dhe gratë sot nuk ndryshojnë ndjeshëm nga ato të prindërve të tyre. Në shumicën e ekonomive familjare, pritet që gratë të jenë përgjegjëse për punët e shtëpisë, pavarësisht statusit të tyre të punësimit, ndërkohë që burrat vazhdojnë të mbajnë barrën e plotë të sigurimit financiar. Rrjedhimisht, kompetencat e vendimmarrjes ose u ndahen burrave ose ndahen në mënyrë të barabartë, por shumë rrallë janë në duar të grave. Detyrat e kujdesit për fëmijët vazhdojnë të konsiderohen domene të gruas dhe, në skenarin më të mirë, burrat mund të angazhohen vetëm në ndihmë në këto detyra. Andaj, pushimi i atësisë shihet gjithashtu si ndihmesë për pushimin e lehonisë, në vend të një mjeti për rritjen e përfshirjes së babait në edukimin e fëmijëve të tyre. Përveç kësaj, dhuna e përjetuar nga djemtë në fëmijëri shoqërohej zakonisht me shfaqje të sjelljeve të dhunshme kur këta djem të rriten e të bëhen burra. Normat gjinore shtriheshin përtej familjes, pra edhe në pritshmërinë për sjelljen dhe rolet e të tjerëve. Qëndrimet homofobike ishin të përhapura në Kosovë, duke qenë se homoseksualiteti ende konsiderohet i panatyrshëm dhe i padëshiruar nga shumica e burrave dhe grave sot. Tiparet e kulturës së përdhunimit ishin gjithashtu të pranishme në pikëpamjet e burrave dhe grave në Kosovë, ku fajësimi i viktimës në rastet e përdhunimit nuk ishte i pazakontë. Puna seksuale kryesisht konsiderohej e pamoralshme, gjersa një numër i madh i burrave pranuan se janë angazhuar në marrëdhënie transaksionale. Së fundmi, kuadri institucional për barazinë gjinore në Kosovë përfshinte një balancë të mirë të vlerësimit të burrave dhe grave, si dhe akterëve të përfshirë. Sidoqoftë, ndonëse të mira në letër, zbatimi i ligjeve, mekanizmave dhe politikave të tilla lë shumë për të dëshiruar në realitet.

## 5.Rekomandime

Ndryshimi i normave sociale, qëndrimeve, dinamikave të familjeve dhe vendimmarrjes, si dhe ndryshimet në praktikat dhe sjelljet e përditshme të burrave dhe djemve në lidhje me marrëdhëniet e tyre me gratë dhe vajzat, kërkojnë qasje të integruar. Rekomandimet aplikohen për autoritetet lokale dhe qendrore, partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët e shoqërisë civile.

### *Rekomandime të përgjithshme*

- 1. Të angazhohen akterët kyçë në shoqëri për t'i ndryshuar marrëdhëniet dhe normat që përçojnë pabarabazi maskuline:** duke punuar me politikën, komunitetin fetar, biznesin, shoqërinë civile dhe liderë të medias, burra dhe gra, jo vetëm në nivel individësh, por edhe në nivel komuniteti; duhet të ndodh ndryshim i qëndrimeve ndaj roleve gjinore të burrave si ofrues të ardhurash dhe grave si kujdestare. Ndryshimi i normave dhe qëndrimeve është parakusht për ndryshimin e jetës politike dhe publike.
- 2. Të angazhohen burrat në mbështetje të një agjende gjithëpërfshirëse të politikave për të drejtat e grave:** shumica e burrave mbështesin ligjet dhe politikat që nxisin barazinë e plotë midis burrave dhe grave. Kjo gjetje konfirmon rëndësinë strategjike të angazhimit të burrave dhe djemve si aleatë në mbështetjen e agjendës së politikave për të drejtat e grave. Duhet të identifikohen liderët kryesorë politikë dhe të komunitetit dhe të mbështeten për t'ju prirë fushatave, duke i bërë ata publikisht të dukshëm si aleatë në fuqizimin e grave.
- 3. Të ndryshohet mënyra e socializimit të djemve dhe vajzave, që do të çonte në ndryshim të sjelljes gjatë moshës madhore:** Rezultatet e hulumtimit konfirmojnë se përjetimet në fëmijëri, nga të qenit dëshmitar i dhunës e deri tek të qenit dëshmitar i dominimit të burrave në vendimmarrjen e familjes, përsëriten prapë në moshën madhore. Burrat të cilët si fëmijë e kanë parë babanë apo figurat e tjera mashkullore në familje më të përfshirë në shtëpi, janë më me gjasë t'i përsërisin këto sjellje gjatë moshës së tyre madhore. Masat afirmative dhe veprimet pozitive në sistemin arsimor, raportimin medial dhe organizatat e komunitetit do të çojnë në ndryshime në familje por edhe në nivel makro-social.

### *Rekomandime specifike të politikave*

- 1.** Duke u mbështetur në suksesin e politikave ekzistuese të barazisë gjinore, të integrohet çështja e burrave dhe angazhimi i burrave për barazi gjinore si tema të ndërthurura në Programin e ri shumëvjeçar të Kosovës për Barazi Gjinore, i cili është në zhvillim e sipër.
- 2.** Të institucionalizohet mbështetja për organizatat e komunitetit dhe të rinisë që fuqizojnë djemtë, por edhe vajzat, si agjentë të ndryshimit për barazinë gjinore. Duke nxjerrë mësim nga aktivitetet ekzistuese, siç janë aktivitetet shkollore jashtë-kurrikulare, kampet verore dhe klubet “bëhu burrë” duhet të shërbejnë si bazë për zhvillimin e programeve të reja, që duhet të zbatohen në zonat rurale dhe urbane.
- 3.** Të promovohet kujdesi dhe përfshirja e burrave në punët shtëpiake dhe përfshirja e plotë e grave në vend të punës si prioritet i politikës qeveritare. Kjo jo vetëm që do të çojë në një jetë familjare më të barabartë, por edhe do të mbështesë zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.
- 4.** Të angazhohet sektori i shëndetësisë si pikë hyrjeje për angazhimin e burrave si aleatë në barazinë gjinore. Duhet të ndryshohet sjellja e burrave lidhur me kujdesin shëndetësor dhe kërkimin e ndihmës por në këtë mënyrë edhe roli i tyre kur bëhet fjalë për shëndetin e grave dhe fëmijëve.





Shtojca I - Lista e të intervistuarve për intervistat e hollësishme

	Institucioni/Organizata	Emri, mbiemri dhe pozita/funksioni	
Institucionet	1	Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë	Edi Gusia, Drejtore
	2	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjeve, Prishtinë	Bajram Kelmendi, Drejtor i Përkohshëm
	3	Avokati i Popullit në Kosovë, Prishtinë	Hilmi Jashari, Avokat i Popullit
	4	Policia e Kosovës, Prishtinë	Tahire Haxholli, Shefe e Njesisë së dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve
	5	Zyra për Avokim dhe Ndhmë të Viktimave, Zyra e Prokurorit	Basri Kastrati, Udhëheqës i Zyrës
	6	Gjykata e Apelit Prishtinë	Biljana Rexhiq, Gjyqtare
Organizatat Ndërkombëtare dhe Organizatat joqeveritare	7	Zyra e UN Women në Kosovë, Prishtinë	Vlora Nushi dhe Linda Sanaja
	8	Programi i USAID për të Drejtat Pronësore, Prishtinë	Merita Limani, Specialiste për të drejtat gjinore dhe pronësore
	9	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, Prishtinë	Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit
	10	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, Prishtinë	Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive
	11	Sinergija, Mitrovicë e Veriut	Stefan Veljkovic, Drejtor i Programit
	12	Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë, Prishtinë	Kadri Gashi, Projekti i Iniciativës - Burrat për të Rinjtë
	13	Strehimorja për viktimat e dhunës në familje në Pejë	Ardita Bala, Drejtore
	14	Kosovo 2.0, Prishtinë	Besa Luci, Kryeredaktore
	15	Rrjeti i Organizatave të Grave të Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve	Shpresa Agushi, Drejtore Ekzekutive
	16	Shoqata Santa Maria, Zveçan	Blagica Radovanoviq, Drejtore Ekzekutive
	17	Qendra për Barazi dhe Liri, Prishtinë	Blert Morina, Menaxher i Programit
	18	Women for Women International, Prishtinë	Iliriana Gashi, Drejtore
	19	Veprim për nënat dhe fëmijët, Prishtinë	Mrika Aliu, Drejtore Ekzekutive
	20	Medica Kosova, Gjakovë	Veprora Shehu, Drejtor Ekzekutiv
	21	Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut, Mitrovicë Jugore	Vetone Veliu, Drejtore Ekzekutive
22	Shoqata e avokatëve NORMA, Prishtinë	Valbona Salihu, Drejtore Ekzekutive	
Ekspertë dhe akademikë	23	Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës	Nita Luci, Profesor Asistent
	24	Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave	Ariana Qosaj Mustafa, Drejtore e Programit dhe Hulumtuese e Lartë
	25	Universiteti i Gracit, Austri	Elife Krasniqi, kandidate për doktoratë
	26	CARE International, Zyra në Kosovë, Prishtinë	Besnik Leka, Koordinator i Projektit



